

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

844-2  
ME

SULEJMAN  
MATO

BUKE  
NE  
SHKEMB  
DRAME


814-2

N140

SULEJMAN MATO

# BUKE NE SHKEMB

dramë në dy pjesë



LIBRARIJA NACIONALE - TIRANA - 1967 - 1000 KOMBI - 1000 LIRE - 1000 DALLAR

SHTEPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

## PERSONAZHET :

AGIMI — agronom, 24 vjeç

AGOJA — gjyshi, rrëth 100 vjeç

AXHEMI — kryetari i kooperativës

ZARIKA — e bija, 17 vjeçe

YLLI — djali, ushtar 20 vjeç

AZBIU — brigadier

DËFRIMI — djali i tij

VELIU — vëllai i Azbiut

MERUSHJA — e shoqja e Axhemit

BEQIRI — djali i kulakut

HODOJA — kooperativist

LAVDOSHI — sek. i partisë, kooperativist

MINEJA — kooperativiste

METIA — brigadier

SPIROJA — tekniku i bletëve

OPERATIVI I ZONËS

Ngjarja zhvillohet në një nga fshatrat malore të labërisë, aty nga viti 1966, në periudhën kur u shtrua problemi i sigurimit të bukës në vend.

## PJESA E PARE

### Tabloja e parë

Dekori paraqet një shtëpi guri të mbuluar me plloça me një verandë. Përsipër saj është hedhur një hardhi, më tutje duket një kumbull e lulëzuar. Muzg. Dëgjohen zilet e bagëtive që kthehen nga kullota dhe një këngë labe që këndojnë të rinjtë te shtëpia e kulturës. Te veranda, ku është vendosur një postiqe deleje, ku rri gjyshi mbrëmjeve, vjen Zarika me një tabaka në dorë. E vendos tabakanë brenda dhe del përsëri jashtë.

ZARIKA — Gjysh! Ku je, gjysh!?

AGOJA — (Që jashtë skene.) Ç'është? — AGOJA

ZARIKA — Sihariq, gjysh!

AGOJA — (Hyn në skenë me një kusi qumështi në do-rë.) Pa hë, pér hajër!

ZARIKA — Gjeje vetë kush të ka ardhur nga Tirana...

AGOJA — Demiri? ...

ZARIKA — Jo.

AGOJA — Aliu?

ZARIKA — Jo, gjysh, jo. S'ka pér të të vajtur mendja po s'ta tregova unë. Yt nip, Agimi. Ka ardhur të punojë agronom në fshatin tonë.

AGOJA — Ç'thua? Po ty kush të tha?

ZARIKA — E takova vetë te kryesia e kooperativës, isha me babanë. Mua nuk më njoju, si duket s'më mbante mend.

AGOJA — Po ku është, më paç uratën?

ZARIKA — Ku ta di unë, gjysh, unë kujtova se do ta gjeja këtu. Mos ka mbetur me babanë nga kryesia. (*Sheh Axhemin me Agimin.*) Ja, po vijnë, gjysh!

(*Në skenë hyn Axhemini, kryetar i kooperativës, me Agimin. Agimi mban në njëren dorë pallton dhe në dorën tjeter një valixhe të vogël.*)

AGIMI — Gjysh! (*Lë valixhen dhe e takon.*)

AGOJA — Hë, qerratai i gjyshit . . .

AGIMI — Mirë, mirë qenke gjysh, si një lis që lëshon çdo pranverë sytha të rinj.

AGOJA — Po ju u bëtë haram të gjithë, jua mori mendjen Tirana.

AXHEMI — Bëjnë ç'bëjnë asaj Tirane e këtu e kanë kokën. Edhe ti bëre 18 vjet nizam e kurbet po këtu erdhe e zure rrënje të forta. Po mbush një shekull e s'po shkulesh dot.

AGOJA — Duhet të njoħesh kurbet, më paç uratën, që të dish ç'është guri yt, ç'është malli për vatanin: (*Agimit.*) Po eja, more bir, të futemi brenda se jashtë u err.

AXHEMI — (*Agimit.*) Ti çmallu me gjyshin dhe eja nga ne se na ka ardhur Ylli me leje nga ushtria.

AGIMI — Falemnderit, xha Axhem, po kam kaq kohë pa e parë gjyshin, sonte nuk vij dot.

AXHEMI — Po s'erdhe do dërgoj Zarikën të të marrë me zor.

AGIMI — (*Sheh Zarikën.*) Zarika, si s'të njoha fare?  
(*Shkon e takon.*) Sa qenke rritur!  
ZARIKA — (*Pak e drojtur.*) Unë të njoha që në filim...

AGIMI — Dhe u takuam më duket.

AXHEMI — Si s'e takove, po ç't'i bësh. Kanë kaluar këq vjet. Sa u bënë që s'je dukur këtyre anëve?

ZARIKA — (*Nxiton.*) Katër vjet.

AGIMI — Tamam plot katër vjet që s'kam shkelur në fshat. Gjithmonë i kam kujtuar me mall rrugët e fshatit, arat, shtëpitë, blegërimën e dhive, ajrin e pastër të mëngjeseve. Gjithmonë kam ëndërruar që pushimet e verës të vija t'i bëja në fshatin tim. Por shkolla, aksionet.

AXHEMI — Të presim! Ta dish na mbetet hatri. Eja dhe ti, gjysh. (*Del. Nga komshitë dëgjohet një këngë e shtruar labe. Në skenë ka mbetur Agoja me Agimin.*)

AGIMI — Po hë gjysh! Kështu të kisha në kujtesë. Siç duket po mbushi njeriu një shekull dhe s'e mundi vdekja e lë të livadhisi azat asqer.

AGOJA — (*Vë kusinë me qumësht në kremastar.*) Aha, këtë vit sikur s'jam më ai i pari. Kanë filluar të mos më bëjnë më gjunjët edhe drita e syve po më soset. (*Hyjnë brenda.*)

AGIMI — Edhe ti gjysh... sa letra të kemi bërë që të vije, po s'luajte që s'luajte nga istikami yt.

AGOJA — E ç'të bëj edhe atje, në Tiranë, sikur më zihet fryma. S'është mësuar trupi im të jetojë nëpër fusha, do erë mali. Këtu jam mbret e padisha. Dal darkave jashtë e shoh si lulëzon kumbulla, si rritet hardhia dhe bie në kujtimet e hidhura të jetës që shkuam. Shikoj këto toka që

rinia po i kthen në tarraca buke e më kënaqet xhani. Herë herë, silloisem me vete: «Pse ikën të gjithë vërsnikët e mi, u bënë baltë e lule e më lanë mua? Siç duket duhej të mbetej një farë nga e kaluara se ndryshe s' shpjegohet dot. Vetëm një gjë është, biri im. Sa më tepër të ikin vitet, aq më shumë të hyn në zemër kjo djallo jetë. Mirë më the qëparë «s'luajte nga istikami», se vërtet në istikam me vdekjen jam. Ë hë! Kur s'më mori në ato vite zor se më merr në këto vitet e reja të partisë. Mos të mërzita me muhabet, më paç uratën? Ty të ka marrë uria. (*Ngrihet dhe sjell para një pjatë me mjaltë.*) Merr pak mjaltë. Është nga bletët e mia. Se njeriu, që the ti, kur rri vetëm i zë dhe gjuha myk.

AGIMI — Jo gjysh, vazhdo. Kam qejf të të dëgjoj.

AGOJA — E që the ti, jetë që do mbajë mend është kjo e 30 vjetëve. Kisha qejf të jetoja dhe nja dy a tri vjet, të them të drejtën, se dua të shoh ç'të mira të tjera do t'i sjellë Shqipërisë Enver Hoxha... Mbrëmë hapa radion dhe ç'dëgjova thua ti; fliste vetë shoku Enver Hoxha për mundimin e grave dhe zërin e tij unë e dëgjoja sikur e kisha mysafir në konakun tim. Si lum ti, biri im, që do i jetosh e do i gëzosh këto vite... Po yt atë, Demiri, si është me shëndet?

AGIMI — Me shëndet keq është, gjysh. Më ka dhënë dhe një letër për ty.

AGOJA — Qerratai... kujtohet nganjëherë, dhe nis nga një pusullkë. Po hë? Pa ma lëçit, ç'thotë?

AGIMI — (*Lexon letrën.*) Na ka marrë malli... dëshirojmë të jesh dhe, ti mirë...

**AGOJA** — (E ndërpret.) Posi! Kështu me letra, se vannë kaq kohë që s'i ka shkelur këmba në Kutas.

**AGIMI** — (Vazhdon të lexojë letrën.) Kam dashur të vij por siç do të thotë dhe Agimi kam qënë së-murë me tension...

**AGOJA** — (Ndërpret letrën.) C'i thonë jatronjtë?

**AGIMI** — Ç't'i thonë. Së shpejti del në pension.

**AGOJA** — U bë harram fare ai djalë. Po bën katër vjetë që s'ka shkelur në këtë prag, nejse, përveten e tij e ka. Dhe në Hin e në Jemen të ishte do të kishte ardhur njëherë. Tetëmbëdhjetë vjet kurbet bëra, më paç uratën, dhe erdha pësse a gjashtë herë këtu. E me të ardhurat e atëhershme. Tetë ditë me pampor e dy ditë rrëth e rrëth maleve që të vije gjer këtu. Po lëre se nesër ç'do bëjmë gjithë ditën. Ha mjaltë. Merr ca dhe ca kokrra arra.

**AGIMI** — Jam lodhur, gjysh, dhe s'kam uri. Shëtitë sot pas mbledhjes me xha Axhemin brigadë më brigadë.

**AGOJA** — Bëj një përshest atëherë. Bukë misri s'besoj të kini atje në Tiranë.

**AGIMI** — Kemi, gjysh, kemi dhe bukë misri. Mamaja blen gjithnjë se e ka qejf. Më kujton fshatin, thotë.

**AGOJA** — Ashtu është, posi. Ajo ia di kimetin bukës së misrit. Po sot na e siguron dhe bukën shteti dhe kjo s'është parë e dëgjuar. Mirë më parë që jetonim me bejlerë mbi kokë po sot ç'na mungon që të mos arrijmë të nxjerrim as bukën e vvetveta? E shkoqita këtë dhe me Axhemin mbrëmë.

**AGIMI** — Ja, për këto u bë sot dhe mbledhja.

AGOJA — Po hë? Ç'doli andej se harrova të pyesja Zarikën, se vet s'munda të vija dot.

AGIMI — U rrahën mendime. Po akoma ka ngurri-me.

AGOJA — Ashtu? Ka akoma njerëz që s'u vjen turp të rrojnë me bukën e tjetrit. Po ti, more bir, fole?

AGIMI — Jo, gjysh.

AGOJA — Të kishe folur! Të kishe folur e t'u thoshje si është e vërteta. Ka një sy të largët kjo parti. Nuk gabon kollaj. Gjer tani s'kemi dëgjuar të ketë thënë një gjë e të mos jetë bërë. Po shkenca ç'thotë për këtë?

AGIMI — Shkenca e tokës nga praktika del, gjysh. Ja, ti në kopshtet e tua, që i ke punuar e plehëruar me kujdes, si ke dalë këto vite?

AGOJA — Ah! Mos e pyet atë punë. Për bimën, më paç uratën, do kujdesur si për fëmijën. I jep dot ujë fëmijës në vapë? Jo, se ka djersë e ftohet. Kështu ndodh dhe me misrin, po e ujite në vapë, ftohet. Në kopshtet e mia, që the ti, kam marrë dhe 20 thasë me misër. Pa bjeri kalemit një çikë.

AGIMI — Po, ke të drejtë. I bie që ti të kesh marrë 25-30 kv. për hektar.

AGOJA — Posi. Po ç'e do tani që më lanë sytë ..

AGIMI — Po sot më çuditi pak xha Axhemit që ngurronte. Ai është kryetar dhe i di më mirë këto punë.

AGOJA — (*Nervoz.*) S'bëhet vreshti me urata, biri im; po me shata e me lopata. I ati i Axhemit s'bënte në ara as sa gjysma ime. Pse? Se i pëlgente të merrej dhe me cangadhe. Po ti s'hën-

(wo) gre fare. Mos më kurse se të gjitha të mirat këtu i kam. Për të gatuar më ndihmon Zarika e Axhemit. Ajo dhe më lan ndërresat. Më është bërë vajzë e shkuar vajzës. Po ç'e do, më duket se kanë një fjalë ta fejojnë me djalin e Azbiut. Dëfrimin. Shumë herë më ka shkuar mendja, kur s'u gjet një nipçë për të ...

AGIMI — Sá është rritur dhe zbukuruar ...

AGOJA — C'pyet. Jeta bën të sajën. Ca ikin e ca vijnë. Po fshati s'mbetet asnijëherë shkretë. Jeta, biri im, është si ai bari, ti e shkul këtë vit, vitin tjetër ai mbin e rritet prapë. (*Ndërkohë hyn Beqiri.*)

BEQIRI — Xha Ago, mos është gjë këtu kryetari. (*Sheh Agimin.*) Agimi! (*E takon me përzemërsi.*) Mirë se na ke ardhur. S'më mbake mend më duket ... Beqoja jam. Po tani të kujtohem? Kemi qenë bashkë në klasë të parë.

AGIMI — Ashtu? Po, po më kujtohesh. Po dhe ke ndryshuar. (*I qëndron pak ftohtë.*)

BEQIRI — Helbete, ju të qyteteve kini hak të mos na njihni, sa fytyra ndërroni, e ne pak që njohim i ngulitim mirë në kujtesë.

AGIMI — Ashtu është.

AGOJA — Po ty, more djale, ç'e mirë të solli këtu?

BEQIRI — Desha një çikë kryetarin, xha Ago.

AGOJA — Kryetarin shko kërkoje në shtëpinë e tij.

BEQIRI — Të ka mbetur qejfi ty, xha Ago, që s'të kam shkelur në derë se më prite me këmbët e para.

AGOJA — Qejfi do të më mbetej po të më shkelje në derë.

BEQIRI — (*Qesh me hidhërim.*) Je burrë plak dhe kam pasur respekt. S'doja që dhe ti, xha Ago, të

shkoje me mendimin e disave. (*Ndërron ton.*) Se ç'ka bërë në të kaluarën im atë, e ka bërë im atë. Të ligat dhe hesapet e kësaj bote i mori me vete në varr. Unë s'jam Zenuni por Beqiri, që më ka gjetur kalama dhe më ka rritur kjo parti dhe, po ta dojë nevoja jap dhe jetën përtë. Ky jam unë!

AGOJA — Tët atë dhe të duash s'e mohon dot se je mish i gjakut të tij. Ta them, meqë e hape këtë muhabet se s'e patëm në mend.

BEQIRI — Ke gjë me mua, xha Ago? Këtë më thuaj! (*Agimit.*) Nejse. Na është bërë qejfi për ardhjen tënde. Pavarësisht nga këto muhabete, po të kini nevojë... do të më mbetej qejfi po të mos më përfillje dhe të mos trokisje në derën time.

AGIMI — (*Për mirësjellje.*) Faleminderit.

BEQIRI — (*Duke dali.*) Do të më mbetej qejfi seriozisht. Jo vetëm si komshinj por... dhe si moshatarë që jemi. Natën e mirë!

AGOJA — Na u prish gjiza se i mbetet qejfi një spurdhjak! (*Qesh i vetëkënaqur.*) Më plaçin sytë mua në erdhi për kryetarin!

AGIMI — Ashtu?! Po përsë erdhi?

AGOJA — Për ty. Kujtoi se do të gënjejeshim, do t'i harronim yneret e tyre dhe do t'ia shtronim sofrën. Ah, si futen këta! Gjënë më të mirë që ka bërë kjo parti është kjo, që ca të tillëve ua ka vën frerin te goja. Se ujkonja, biri im, vetëm ujq mund të pjellë. E ku e patëm llafin...

AGIMI — Te buka, gjysh.

AGOJA — Hë, më paç uratën, këtu ta kisha. Puna nuk të plak kurrë, biri im. Të plak halli. Ja, unë njëqind vjeç po mbush së shpejti e belin dhe

kosën s'e kam lëshuar nga dora. Se po e lëshova nga dora belin, i kam lëshuar të gjitha. Dal e ndihmoj nga një çikë në punët e kooperativës. Vitin që kaloi bëra 105 ditëpunë. Dhe këtë vit kam bërë gjer tani nja 30 ditë. Nga krahët e këmbët mirë jam, po ç'e do, s'jam me sytë mirë! Ç'të bësh... S'do doja gjë tjetër veç të mos më iki kjo drifa e syve e të shikoj me sytë e mindryshimet e tjera të fshatit tonë. (*Agimit.*) Po si the ti?... Demek, do ta sigurojmë dhe bukën në vend... (*Me vete.*) Çudi e madhe si ardhka puna!

(*Dëgjohet kënga andej matanë nga Axhemëi.*)

AGIMI — Ngrihemi të shkojmë, gjysh? (*Blegërin keci në katoq.*)

AGOJA — Mirë, more bir! — Ja, sa të mbyll pak dhitë. Se nga gjëzimi harrova fare. (*Ngrihet.*)

AGIMI — (*Ngrihet.*) Prit! Shkoj unë.

AGOJA — Jo, jo më paç uratën. Rri ti, se më trëmbet syka po pa të huaj. (*Del. Agimi i ndez dritën elektrike që të shohë. Ndërkohë hyn Zarika.*)

ZARIKA — Akoma ju? Andej ju presin. Babai më tha që të vij t'ju marr.

AGIMI — Shumë mirë. Tani sa po bëheshim gati.

ZARIKA — Po gjyshi ku shkoi?

AGIMI — Po mbyll dhitë.

ZARIKA — Ashtu? Po shkoj ta ndihmoj.

AGIMI — S'ka nevojë. Ai tani duhet të vijë. Po ti çfarë punon në kooperativë?

ZARIKA — Çfarë punoj!? Si gjithë të tjerët. Ku të ketë nevojë bujqësia. Ja, sot pas mbledhjes pastruam me shoqet vijat kulluese. (*Nxjerr një karamale.*) Urdhëroni një karamale.

AGIMI — Faleminderit! (*E shikon në sy.*) Më thanë që  
je fejuar.

ZARIKA — Kaq shpejt të kanë informuar?

AGIMI — Të të uroj?

ZARIKA — Jo.

AGIMI — Pse?

ZARIKA — Se unë nuk jam fejuar. Ata që të kanë  
thënë të kanë gënjer.

AGIMI — Gjyshi më tha.

ZARIKA — Gjyshi nuk gënjen por... Unë nuk jam  
fejuar.

AGIMI — Kjo s'do të thotë që s'do fejohesh... (*Pau-  
zë.*) Si e quajnë atë djalin?

ZARIKA — Pse?

AGIMI — E paske sekret emrin e tij. Duket që e da-  
shuron...

ZARIKA — Jo. Nuk e dua. Babai i atij ka biseduar me  
babanë tim. Dhe këtë ti e quan fejesë?

AGIMI — Jo. Gjëra të tillë unë nuk i quaj fejesë. Po  
ty të pëlqen ai djalë?

ZARIKA — Përse po më pyet?

AGIMI — Qenke e çuditshme ti...

ZARIKA — Vërtet? (*Ndërron bisedë.*) Më kujtohet...  
Kur isha gjashtë vjeç më ke shkulur njëherë  
flokët fort...

AGIMI — Dhe ti më ke lëshuar njëherë ca guriçka tek  
burimi nga lart, kur unë po pija ujë.

ZARIKA — E mbake mend? Po sot kur më takove  
nuk më njohe...

AGIMI — Si të të njihja? Ti ke ndryshuar kaq shumë.  
Je rritur, zbuluar. Të viaj një pesë a gjashtë  
muaj më vonë mund të të gjeja dhe të fejuar.  
ZARIKA — (*Me shaka.*) Pse, kaq shpejt i bëni fejesat  
ju andej nga qyteti?

AGIMI — Si të të them. Po ju këtej nga fshati?

ZARIKA — Edhe këtej: si të të them. (Qeshin të dy.)

*Dëgjohet kolla e Agos.)*

AGIMI — Shkojmë. (Dalin të dy.)

(Në paraskenë qendron Beqiri në këmbë i mërzitur në gjysmë errësirë. Dëgjohet këngë labe nga shtëpia e Axhemit.)

### Tabloja e dytë

Dekori: oborri i shtëpisë së Axhemit me një kumbull të bardhë të lulëzuar. Në verandë është vendosur një tavolinë. Kanë ardhur tek Axhami për të uruar mirëseardhjen e Yllit: Azbiu, Veliu, Lavdoshi, Hodoja, Metia dhe Meneja që hyn e del duke sjellë bashkë me Merushen qerasjet e rastit. Pak më tutje është ulur Agoja. Të rinjtë: Ylli, Agimi dhe Zarika bisedojnë midis tyre. Kur hapet perdja burrat janë mbledhur kokë më kokë duke kënduar për qëndrimin e Partisë sonë në Moskë. Ia ka marrë Hodoja:

Enver Hoxha mu në Moskë

Hrushovit ia numëroi

ia përplasi në fytyrë:

«Ne me ty s'jemi dakord!»

ZËRA — Gëzuar Axhem! Gëzuar Merushe dhe në das-më!

AXHEMI E MERUSHJA — Faleminderit!

(Nisin përsëri bisedat dy e dy.)

**AXHEMI** — Dhe që the ti, (*Azbiut.*) Lavdoshi s'ju foli shkoqur në mbledhje. Sekretari i parë më pyeti mua pér të marrë një mendim. Unë, ju thashë dhe në mbledhje nuk u angazhova. Po pse e bëra këtë? Se desha që këtë gjë ta shoshisnim njëherë këtu me njëri-tjetrin. Unë nuk mund të angazhohesha ashtu fët e fët para partisë pér një problem që s'e di as vetë si do bëhet dhe të vija e të kapardisesha këtu para jush e t'ju thosha se ja: unë e mora zotimin para partisë se do ta nxjerrim bukën në vend. Hëni ju tan! (*Ndërron ton.*) Jo, unë jam kryetar, jam burrë mbi të gjitha, s'duhet të nxito-hem, të shes mend para partisë dhe pastaj kur të vijnë të korrat ta ha turpin me bukë.

**AZBIU** — E kush është ai që s'e do një gjë të tillë, o kryetar, por si do të bëhet se... Bokërrimat që kemi mezi na kanë nxjerrë bukë pér tre-katër muaj e si mund ta bëjmë bukën e një viti?

**MINEJA** — (*Ndërhyn në muhabet të burrave.*) Gjersa këtë gjë e thottë partia domethënë që ajo këtë punë e di më mirë se ne, pa çka se ajo na e thottë një çikë si butë, si propozim... Ndaj të mos shpejtohem, por t'i vëmë gishtin kokës e të mos lëshojmë si aty në mbledhje aguridhe.

**HODOJA** — Është puna që këto koka të kenë besim te toka që do i kërkojmë të prodhojë, krushkë! Pa t'i biem lapsit një çikë; 60 ha tokë që ka fshati ynë sigurojnë gjithë-gjithë pér tre-katër muaj drithë, atëherë si ta ha mendja ty që t'i thoshte Axhemit sekretarit se ne do ta sigurojmë bukën në vend? Me urdhërin e peshkut? Se, pér fjalë jemi të gjithë të vetmit ne, por kur vjen puna, tjetër hesap pastaj. Po kopaçet i ha krye-

tari, se atij i kérkojnë llogari. Ku je, more shoku Axhem Xhafa, i thonë. Ku i ke ato fjalët e bukura që na premtovë?

VELIU — Ashtu, ashtu éshtë!

METIA — Ti, o shoku Hodo, mirë e nise po s'e bitise mirë.

HODOJA — Pa hë, si na thua ti?

METIA — Posi. (*Ngrihet në këmbë.*) Partia na pyet, nuk na jep urdhëra dhe as nuk kérkon llogarira të tilla si thua ti. Të rrimë shtrembër po të flasim drejt. Kush na ushqen me bukë? Kush i jep kooperativës sonë 800 kv. drithë në vit? Shteti na i jep. E ku e gjen shteti këtë grurë e këtë misër?

HODOJA — Dhe në e kam nga depot e shtetit me lekë e kam blerë e s'e kam marrë baxha.

METIA — Me lekë natyrisht. Po shteti e ka blerë sa frëngu pulën me dollarë atë grurë.

VELIU — E q'do të thuash ti me këtë?

METIA — Të them ty dhe vetes që thirrjen që na bën partia ta kuptojmë një çikë më mirë. Se dhe sot në mbledhje e përdrohje fjalën sa andej këtej e s'dole në asnjë shteg. Partia na pyet: o pull i Kutasit, «heroik i Kutasit», na thotë, pa shih një herë, ti vetë ç'mund të bësh me ato bokerrimat e tua për veten tënde pa po s'bëre dot gjë, pa bukë s'të le njeri sot, or jo. Ndaj mirë foli Lavdoshi në mbledhje. S'ka pse ta diskutojmë fare nëse e bëjmë a jo këtë punë, po të diskutojmë si do bëhet e ku bëhet gruri ose misri në këto toka që kemi.

MERUSHJA — Të hapim tokë të re, të kthejmë tokën e Kumarovave në tokë buke, të shikojmë mos

hapim tokë të re në majë të Drerit, në Langadha, në Bërda ...

VELIU — Në Langadha, u tha njëherë, s'ke ku të hapësh tokë të re veç atyre që janë, pjesa tjetër janë kullota të blegtorisë.

METIA — Do ta shikojmë dhe atë ...

AZBIU — Shikoje ti xhanëm, shikoje ... Kujton se do të të lërë njeri të prishësh shtëpi e të bësh kënaçe.

YLLI — Nuk është ashtu. Buka nuk është kënaçe.

AZBIU — Po çfarë t'i themi kësaj, të lutem shumë? Partia e di që ne jemi kooperativë blegtorale **dhe 80% të të ardhurave vjetore i nxjerrim nga blegtoria.** Dhe gjersa të ardhurat i kemi këtej, natyrishq që asaj do t'ia bëjmë dhe yzmetin më të madh. Po si do ta rrësim rendimentin e mishit dhe qumështit që na kërkohet në qoftë se dhe ato pak kullota që kemi i kthejmë në toka buke? Unë s'them se s'jam dakord me propozimin që na bëhet por jo dhe në kurriz të blegtorisë ama. Se çdo kooperativë ka specifikën e saj. Se si thua dot Myzeqesë rrit bagëtinë, po i thua rrit grurin, se bagëtinë s'e rritin dot fushat por heja e maleve tona.

YLLI — Edhe në Myzeqe nga kënetat e djeshme e nxorën bukën e grunjtë. Unë i di mirë vështirësitë e tyre se atje bëj ushtrinë.

AGOJA — Unë tani po shkel në të njëqindat. Ju flisnit për bukën e mua m'u kujtua e kaluara, kur niseshim me nga një thes në krah e shkonim në qytet tek Jorgji Duanoja dhe i luteshim të na shiste një okë misër. E merrnim atë çikë misër dhe ngjiteshim prapë këtu sipër, në Kutas për t'ua bërë bukë kalamanjve. (*Ashpér.*) Buka, bij-

të e mi, është jetë. Sa mbaj mend unë, fshati ynë kështu e ka kaluar në këto copë toka që kemi. Ky short na ra. Në këto harca erdhën e u ngulën të parët tanë. Ata që duan të ikin prapa die-llit të venë, ne na rëndojnë në zemër këta gurre e s'na kanë lënë të luajmë nga vendi. Po unë që u dëgjova të gjithëve, një gjë u them: njeriu sot, me këtë Parti, e mbjell kokrrën e grurit e e bën të mbijë dhe në majë të shkëmbit, më paçi uratën. Qysh se ka lindur kjo parti s'mbaj mend të jetë thënë një gjë dhe të mos jetë bërë.

AZBIU — Mirë, more vëllezër, po si do të bëhet kjo punë, a s'më thoni? Se dhe budallenj s'ka pasur fshati ynë që mos ta kenë vrarë mendjen për këtë punë.

LAVDOSHI — Ta them unë. (*Ngre zërin.*) «... Nuk ka vënd socialist në botë që të jetojë, punojë dhe të luftojë në rrëthim si vendi ynë» thotë shoku Enver. Kjo është situata.

MINEJA — Për atë bukë, bar të hamë e dorën të mos ia zgjasim depove të shtetit që shteti ynë të mos blejë drithë me të shtrenjtë.

AZBIU — More, sikur të dëgjonim dhe zërin e rinisë (*Duke u drejtuar nga Agimi.*) si të shkolluar dhe që ua pret mendja për këto punë, se s'uadëgjuam zërin as në mbledhje.

AGIMI — Unë s'vij këtu për të kaluar kohën, po kam ardhur këtu që të punoj së bashku me ju. Buka mund të sigurohet dhe unë do të punoj së bashku me ju e do të përpinqem që bukën ta sigojmë në vend. Edhe toka është si bagëtia, ushqjeje dhe mirëmbaje që të të japë rendiment. Këtë ju e dini më mirë se unë. Unë mendoj, që po të shfrytëzohet plehu shekullor i

Kakomesë, rendimentet do të trefishohen dhe të katërfishohen.

VELIU — (*Ironik.*) Ç'thuat! Po kjo punë qenka e bittisur ...

AZBIU — Unë, të them të drejtën, vetë akoma s'kam asnjë mendje se si do bëhet kjo punë. Se mos mora shkollë unë që të vija t'ju flisja këtu si ky, djali i Demirit, me shkencë. Po tani menjoj: Lavdoshi s'flet keq. Po dhe kryetari, që di më shumë se unë e Lavdoshi e të gjithë ne, të vërtetën tha. Se Axhemin që e kemi zgjedhur pér kryetar s'e kemi zgjedhur pér mustaqet e bucura, se mustaqet unë i kam më të mira se të atij (*Qeshin.*) po ç'e do se ai ma kalon në ca gjëra të tjera, se ia pret kaplloqja më shumë se unë e ty e ndonjë tjetri.

LAVDOSHI — Ty, Azbi, s'të ka vënë njeri gjykatës që të na vlerësosh se kush ka të drejtë. Pra, partia e di që fshati ynë malor ka pak tokë buke, por ka besim te ne ama, se fshati ynë, që ka dhënë gjakun è bijve të tij pér këtë ditë, do ta pleqëronte këtë punë. Kështu apo jo, more shokë.

ZËRA — Ashtu, Ashtu. Të drejtë ka Lavdoshi.

LAVDOSHI — Armikun kemi ditur ta vrashim me plumb. Po me bukë, a e vrashim dot me bukë!? Kjo duhet parë, o Azbi; ta vrashim armikun dhe me bukë.

HODOJA — Do ta vrashim, a derëbardhë, dhe me bukë, po ngrije njëherë.

AXHEMI — (*I revoltuar.*) More, pa dale, se ca po na dalkan iniciatorë e ca na qëndrojnë në bisht të situatës. Po të jetë kështu atëherë hajde se po tregohem unë i pari më optimist se ju, por ne

u nisëm ta diskutojmë këtë punë. Të flasim realisht. Se unë vërtet jam kryetar po nuk i komandoj dot ngricat e shirat e tu them: ju lutemi shumë, këtë vit të bini kur t'ju them unë se ashtu e kemi punën, se kemi marrë zotime... Hë, e bën dot njeri këtë? Del problemi i tokave të reja... Po pse këtë vit na dalka për herë të parë ky problem? Tokat që i kemi provuar sa prodhojnë i kemi vënë nën bel por në zall e në shtuf nuk mbin misri e gruri. Eksperimentime në kokë të qerosit nuk bëjmë ne.

AZBIU — Ashtu është, ashtu.

MINEJA — (*E revoltuar.*) Si qenka ashtu, të keqen Mineja? Shteti gjëndet i rrëthuar nga armiqtë e partia të bën ty thirrje e ti më përgjigjesh si e ëma e Zegos majë thanës. Këto janë servillëqe, të keqen Mineja, t'i thuash Axhemit dhe kur s'e ka mirë, fol ti fol se mirë e ke. S'kini turp, jini dhe komunistë! Ju ka vënë populli që të drejttoni dhe jo të dilni kundra popullit. Se na kini namuz e ju pëlqen më tepër të ruani namuzin se sa të përvishni llërët. Dhe dëgjoni këtu ju, nga puna s'ka asnë qeder, s'të vjen asnë e keqë nga puna dhe s'të quan njeri gënjeshtar. Gënjeshtar e dembel e parazit e revisionist e të poshtër të quan tjetri kur i bën bisht punës. Kaq kini nga unë. Le të vijnë të hidhurat në fillim të émblat prapa.

AZBIU — (*Me të njëjtin ton.*) Të dëgjuam gjer në fund se të njohim për grua të thjeshtë e punëtore se për ideal s't'i ka njeri borxh këto gorrica që hodhe në shesh. Të gjithë më njojin mua e kryetarin dhe s'ka mbetur puna të na gjykosh ti ne.

LAVDOSHI — Jo, or byrazer. Ja, këta na kanë zgjedhur mua e ty si brigadier e këta kanë të drejtë të gjykojnë punën tonë e llafet tona.

VELIU — More. Do të na lini ta pimë këtë farmak e të gëzohemi për mirëseardhjen e djalit apo të ngrihem e të ikim se na buçasin veshët e na u bë koka daulle sot me mbledhje. Jo kështu, jo ashtu. (*Hodos.*) Nise, o Hodo, të keqen. (*Hodoja fillon këngën:*)

Dilni shokë, dilni  
të gjithë në punë.

Mos u dobësoni,  
mos bini në gjumë.

Thirrni gjithë shokët  
se do vij dhe unë.

Fshatin tonë do lulëzojmë  
vetëm me punë!

(*Të tjerët mbajnë iso.*)

AZBIU — (*Yllit.*) Gëzuar, shoku ushtar! Na u bë qejfi kur morëm vesh se kishe dalë i dalluar në qitje e të kishin dhënë leje. Se, që thua ti, pushkën e ka pasur për traditë shtëpia juaj brez pas brezi dhe ja tani ti na nderove e s're më poshtë se Xhafajt e tjerë.

YLLI — Faleminderit, xha Azbi.

LAVDOSHI — Hajde gëzuar, dhe ti Agim. E mirë se na erdhe! Punë boll do kemi e vështirësi sa të duash, po do t'i kalojmë të gjithë bashkë.

AZBIU — (*Lavdoshit në konfidencë.*) Të thuash atë që është. Në mbledhje pati përçarje.

LAVDOSHI — Debat po. Po, përçarje s'e pranoj. (*Axhemit*) Dhe ti, xha Axhem, u nxitove një

çikë. Dhe s'bëre mirë në sy të kolektivit. «Po që kështu, më hiqni si kryetar». Pse, ashtu hiqen kryetarët?

METIA — Ashtu është. Në parashikime bëmë se mos hodhëm fall e doli ashtu si thamë ne. Mund që ti të kesh të drejtë.

AXHEMI — Në komitet nuk na thanë ashtu, o Lavdosh.

LAVDOSHI — Na thanë që ta diskutonim në popull. Dhe ne atë bëmë. Ne të dy ishim aty thjesht individë dhe shprehëm dhe ne mendimin tonë. Hë, more shokë! Diskutuam për bukën. A bëmë ndonjë gabim në këtë mes? Rrahëm mendime dhe mirë bëmë që i thamë ashtu siç i ndienim. Në mes tonë i thamë nuk ia shitëm armikut de! Ca optimistë e ca pesimistë në këtë punë, ashtu siç jemi në realitet. Ashtu siç janë njerëzit kur nisin një punë. Po optimistë s'do jemi të gjithë që në fillim. Hë, more shokë, flisni! Po të kemi bërë gabim na gjykonin.

METIA — Ne s'kemi ardhur të gjykojmë njeri po për të mirseardhur Yllin. Ne s'e njohim as sot as dje e as pardje shokun Axhem. Kemi një jetë të tërë që e njohim dhe e çmojmë për meritat që ka. Po shokut Axhem i bëj një vrejtje si komunist që jam. Këtë ia kam thënë dhe në mbledhjen e partisë ia them dhe para jush. Shoku Axhem është kuadër i ngritur e punëtor, që gjëzon respektin e masës, por ka një huq që preket shpejt nga kritika. Faj kemi dhe ne që këto vjetët e shkuara s'e keqmi përdorur dhe aq shumë kritikën dhe autokritikën dhe tanë që e kërkojmë na

vjen ca si e hidhur. Po ç't'i bësh. Do të mësohemë.

**LAVDOSHI** — Mendoj se kryetari duhet të kishte folur më ndryshe. (*Me ton të përzemërt.*) E them këtë se në qoftë se masa ka besim te shoku Axhem dhe ti shoku Axhem duhet të kesh më tepër besim te ne, te masa. E them këtë se shokut Axhem, si burrë i pjekur që është, ia dëgjojmë të gjithë fjalën.

**AGOJA** — Pa lerini llafet, bijtë e mi, e përvishiuni punës se llafet e tepërtë janë fukarallëk. S'na thotë njeri të punojmë për të tjerët po për të ushqyer veten. Hë, më paçi uratën, se u bënë 20 vjet qërim e ne hala te ura, 20 vjet që na ushqen shteti me bukë. Se s'jemi të zotë të kollandrim veten. Pa mendojeni mirë njëherë ç'do të thotë kjo? Shumë gjëra kemi bërë por unë them po s'u bë kjo asgjë s'kemi bërë.

**LAVDOSHI** — Ti, xha Ago, ç'na thua, do t'ia dalim dot mbarë kësaj pune?

**AGOJA** — Pa niseni njëherë, niseni se puna ju mëson vetë.

**VELIU** — (*I nxehur.*) Ore kryetar, na ke thirrur për të vazhduar mbledhjen apo për mirëseardhjen e djalit? Ta dimë.

**YLLI** — Epo, ku dhemb dhëmbi vete dhe gjuha, xha Veli.

**AXHEMI** — (*Ndonëse është pak i nxehur por e kap situatën dhe ndërron shprehje.*) Ngrijeni njëherë se vërtet u hutuam fare e harruam dhe përsë jemi mbledhur. E nisëm dhe këtë punë si mbledhje.

(*Hodoja ia merr këngës, të tjerët i mbajnë iso.*)

**ZËRA** — Hajde në gëzime! (*Pinë me fund.*)

## PARASKE NË

Dy porta me strehë. Lart ngjitet një kall-drëm i gurtë fshati. Gjysmë errësirë. Nga njëra anë ka dalë tekniku i bletëve Spiroja, i cili ka ardhur nga qyteti dhe pret dikë. Kalon Azbiu.

SPIROJA — Azbi Dalipi?

AZBIU — (I trembur pak.) Po, unë. Ju kush jeni?

SPIROJA — Unë?! Unë jam tekniku i bletëve.

AZBIU — (I zgjat dorën.) Si jeni?

SPIROJA — Mirë, faleminderit.

AZBIU — (Që e psikologjis.) Po, nga vini?

SPIROJA — Nga qyteti. Keni të fala.

AZBIU — Nga kush?

SPIROJA — Nga ca dashamirës të tu. Që të duan dhe interesohen për ty.

AZBIU — Si e keni hallin? Ç'kini më mua.

SPIROJA — (Nxjerr diçka nga xhepi.) Ju kam prurë diçka. (Ia zgjat.)

AZBIU — (E hap. Çuditet. E mbyll prapë zarfin.) Para! Ç'janë këto para??

SPIROJA — Ah! Pse, paska dhe para brenda? Unë s'di gjë. Mua ma dhanë letrën dhe më thanë meqë shkoni ju në Kutas, t'iа jepni në dorë. Po ju a jeni Azbi Dalipi?

AZBIU — Po, Azbiu jam. Ju pyeta, kush jini?

SPIROJA — Spiro Thomai më quajnë. T'ju pyes...  
(*Jep parrullen.*) «Këtej dimri gjer në ç'muaj  
mban!»

AZBIU — (*E sheh si i çuditur.*) Gjer në muajin maj.  
SPIROJA — Shumë zgjatka.

AZBIU — Shumë zgjat po s'bën zarar.

SPIROJA — Po nuk zë karar.»

AZBIU — (*Merr letrën dhe e fut në xhep.*) Kush ju ka  
dërguar?

SPIROJA — Vetë «Zjarri».

AZBIU — Ah «Zjarri»... Po Lefteri ku është?

SPIROJA — Lefterin e kanë zënë.

AZBIU — (*Brof papritur.*) Ç'thua?!

SPIROJA — (*Qesh.*) Mos u shqetësoni! Për punë  
vjedhjesh. S'i ka faj njeri. Gabimet e veta le  
t'i paguajë me kokë të vet.

AZBIU — Ju pa njeri që erdhët këtu?

SPIROJA — Jo asnjeri.

AZBIU — Shkojmë në shtëpi.

SPIROJA — Jo, do të iki son te. Duhet të fle në Buj-  
kas. Po ç'flitet për sigurimin e bukës?

AZBIU — Shumica janë entuziastë.

SPIROJA — Shumë mirë. Dhe ju në këtë pikë duhet  
të solidarizoheni me vendimet e partisë.

AZBIU — Ky është mendimi juaj?

SPIROJA — Jo. Unë përgjithësisht s'jap mendime, ve-  
tëm i zbatoj ato.

AZBIU — (*Ftohtë.*) Tjetër?

SPIROJA — Tjetër? Si është puna e një krushqie që  
ju duhet të lidhni me kryetarin? (*Azbiu i zgjat  
duhanin.*) Faleminderit! S'e pi.

AZBIU — Do të bëhet.

SPIROJA — Duhet të bëhet. Dhe diçka e fundit për

nga radha por jo për nga rëndësia. Kutasi ka gjashtë pendë që ...

AZBIU — Po.

SPIROJA — Po sikur të mos ketë asnje? ...

AZBIU — Është tepër vonë, plugimet janë bërë.

SPIROJA — Pyeta nëse ju vetë gjashtë pendë qe i quani shumë.

AZBIU — Po kërkohet një çikë si shumë.

SPIROJA — Pse shumë? Ju, me sa di unë, ka kohë që qëndroni nën hije, ndërsa paratë s'di ndonjë rast që të mos u kenë rënë në dorë me gjithë telashet që ka kjo punë.

AZBIU — Iku vafti im. U plaka tanë unë. S'më punon më as truri. Ndërsa kohët po vështirësohen. Vígjilencia rritet dita ditës. E kam biseduar edhe me Lefterin, t'ia thoshte «Zjarrit» nuk e di q'ka bërë. Nuk e di q'mendoni ju ...

SPIROJA — Ju kërkoni të na braktisni tanë që pak nga pak e majmët barkun me paratë tonë.

AZBIU — S'e kam për vete. Por edhe për ju. Një gamim i im ju rrezikon edhe ju ...

SPIROJA — Ju kini filluar të mendoni gjëra të rrezikshme. Na krijoni dyshime që s'na japin më asnje garanci. Për këtë unë jam i detyruar të informoj «Zjarrin».

AZBIU — Kini të drejtë. Ndoshta e kam nga lodhja. Kemi tërë ditën sot që merremi me mbledhjen për sigurimin e bukës.

SPIROJA — Kështu pra, të kthehem përsëri te biseda jonë. Kërkohet nga ju të zhdukni qetë. Si e qysh do ta bëni këtë gjejeni vetë. Rezultati kurorëzon veprën. Mos u fusni vetë. Mirë do të qe të fusnit këtu ndonjë komunist. (*Dëgjohen hapë. Kalojnë Lavdoshi, Agimi e të tjerë, duke*

diskutuar. Azbiu dhe Spiroja fshihen në errësi-  
rë. Dalin përsëri.) ...

AZBIU — Eja të shkojmë në shtëpi.

SPIROJA — Jo, Sonte do të fle në Bujkaj tek një mi-  
ku im. Është mirë edhe për ty. Hajde, suksese  
dhe gëzohem që u njohëm. (Del.)

AZBIU — Mirupafshim! Hë, qentë! Kujtohen dhe vij-  
në e më kafshojnë nga një çikë. Më dhemb, ja  
mu këtu. (Tregon gjoksin.) Kam 23 vjet që jetoj  
si lepuri i fshehur gëmushave duke pritur me  
alarm një grykë revolveri në drëjtim tim.  
(Imiton.) Azbi Dalipi! Të njohëm më së fundi  
se kush je. Shko përpara dhe mos lëviz se t'i  
hodha trutë në erë!

— Ku më çoni??!

— Para gjyqit të popullit! Të japësh llogari për  
të gjitha ato që ke bërë në kurriz të tij!

— Pastaj?

— Pastaj do të të përkëdhelim me një plumb të  
vixehtë... dhe me kaq mbaron edhe historia  
jote. (Shkëputet me egërsi.) Por jo, gjersa jam  
gjallë, jetoj e marr frymë akoma s'ka mbaruar  
historia ime, miq të nderuar!

(Dëgjohet dikush që i thërret. Pas pak del nga  
errësira Beqiri.)

AZBIU — Ti Beqo je, ç'kemi?

BEQIRI — E di si është puna... Nga unë gjer më sot  
s'ke pse të qahesh. Dhe s'të kam kërkuar asgjë.  
Tani kam një hall që ti po të duash ma zgjidh  
me siguri. Axhemini ti e ke mik. Së shpejti do  
të jeni miq e krushq ndërsa unë i ziu...

AZBIU — Ku e ke hallin?

BEQIRI — Po ja kisha qejf dhe unë të shkoja në hi-  
drocentral një vit vullnetar.

AZBIU — (I çuditur.) Ti tē shkosh nē hidrocentral?!  
(Qesh.)

BEQIRI — Po, unë. Pse, c'ka pér t'u çuditur? Dua dhe  
unë tē siguroj tē ardhmen time. Ti e sheh. Nga  
fshati s'kam c'pres më, gjersa tē kemi sekretar  
Lavdoshin. Ti je i vetmi që ma di dhe ma kup-  
ton hallin ... Tek ty i kam varur tē gjitha  
shpresat, Azbi vëllai.

AZBIU — Posi kështu, dashke tē nā lesh vetëm, hë!

BEQIRI — (Mbledh supet.) Epo, c'të bësh. Ti e kup-  
ton vetë. Të isha dhe unë brigadier si ti, tē më  
shkonte fjala gjithandej, vërtetë, s'do ta bëja  
një budallallék tē tillë.

AZBIU — Jo, or, jo. Mos u prif, se s'të lë njeri tē ikësh  
ty, jo. Dhe po tē donte kryetari do tē ta prish-  
ja unë këtë punë.

BEQIRI — Ashtu hë!

AZBIU — Ashtu posi. Dashke tē ikësh zotrote ...

BEQIRI — Azbi, tē kam vëlla, mos më kundërshto, ti  
më ke në dorë. Ndihmomë ta rregulloj dhe unë  
jetën si ke rregulluar tënden. Mendo sikur tē  
ishe nē vendin tim. Ja, vitin e kaluar bëra 360  
ditëpune. Po c'fitova se?..

AZBIU — Ditët e punës fitove.

BEQIRI — E e xhanëm ...

AZBIU — Po c'kërkoke zotrote, mos do që tē tē venë  
dhe nē tabelë tē nderit. Dhe tē tē marrin gaze-  
tat? S'thuha shyqyr që rri i qetë nē shtëpinë tën-  
de ... Po dy deshët e kooperativës, kaq shpejt  
i harrove?

BEQIRI — Pse m'i kujton tanë. A s'ishe ti që më the?

AZBIU — E unë, unë xhanëm, por po tē më luash  
bishtin t'i nxjerr nē dritë dhe tē mori lumi pas-  
taj, prandaj ...

**BEQIRI** — Mua më merr lumi, e ty deti . . .

**AZBIU** — Ashtu thua . . . Kollaj të duket që të aku-  
zosh një brigadier, një njeri të besuar, Kush,  
djali i një kulaku, e pse? Se i ka kërkuar vaj-  
zën për nuse por ai nuk ia dha se s'mund të bë-  
jë pajtim klase me të.

**BEQIRI** — (*Me inat.*) Bukur fort. Nga ti unë gjithmonë  
kam mësuar diçka. Me këtë gjuhë ke folur dhe  
me tim atë?

**AZBIU** — Me një ndryshim, kemi ndërruar rolet. Dë-  
gjo këtu. Jeta ka bërë që unë e ti të lidhem  
së bashku me ca pranga të padukshme. E duam  
s'e duam njëri-tjetrin, ç't'i bësh, fati na lidhi  
bashkë. Dhe të dua mos ta pranoj, kjo është e  
vërtetë. Pra, s'ke si ikën këtej. (*Me ton të ngro-  
htë.*) Më kupto mirë tanë . . . Dhe diçka, Lefterin  
e kanë kapur.

**BEQIRI** — (*I trembur.*) Vërtet?

**AZBIU** — Mos u shqetëso! Vendi i tij nuk ka mbetur  
bosh. (*Qesh. I afrohet dhe i rreh shpatullat për-  
zemërsisht.*) Hë, se dhe ajo puna jote rregullo-  
het por, së pari, na duhet të kryejmë një detyrë  
të vogël . . . (*Beqiri picërron sytë sa djathtas,  
majtas.*) Dëgjo këtu; merr vesh mirë kush pu-  
non në stallën e qeve këto ditë . . .

**BEQIRI** — Pse, si është puna?

(*Ndërkohë dëgjohet zhurmë. Janë njerëzit që  
dalin nga shtëpia e Axhemit.*)

**AZBIU** — Natën e mirë. Nesër mbrëma kur të erret  
më prit tek shkolla.

(*Largohen të dy. Pas tyre kalojnë në skenë të  
tjerët duke diskutuar.*)

### Tabloja e tretë

Pranverë. Sfondi i malit me dëborë. Një gardh nomeje dhe nomeja ku verojnë bagëtitë vendosur në një zallishte të pjerrët. Kapica e plehut dhe kooperativistë e kooperativiste që shkojnë ngarkuar me thasë në krah. Gra të ngarkuara me tërkuzë.

Kur hapet skena dy gra zbresin poshtë. Lavdoshi me një tjetër presin t'u mbushen tha-sët, ndërkohë këndojnë një këngë labe.

AZBIU — (Hyn në skenë dhe u thotë:) Hajde, gati!... (Ata shkojnë, hedhin thasët me pleh në krah dhe nisen poshtë duke kënduar. Ndërkohë nga poshtë vijnë Agimi, Ylli, Zarika, Beqiri me thasë të zbrazur. Mineja sa çon thesin për t'u mbushur shkon pranë djepit ku ka lënë fëmijën dhe i jep gjë. Nga ana tjetër e skenës ngjitten Veliu, Dëfrimi dhe Hodoja të tre me nga një lopatë në krah; ngadalë-ngadalë. Agimi i sheh dhe u del para.)

AGIMI — Jū, qëndroni aty. Pse me vonesë?

VELIU — Kush është me vonesë? Në kohë kemi ardhur.

AGIMI — (Sheh orën.) Kemi thënë që më 7 fiks të ishim këtu, ora po shkon 7 e 20 minuta.

HODOJA — Hë, a derëzi, se s'u bë kiameti. Një çap para një çap pas njëri-tjetrit jemi. Se mos na u hapën zyrat. Po dhe pak të moshuar jemi siç na sheh.

VELIU — Aha, iku vakti jonë. S'matemi dot me ju rininë. Kur ishim në moshën tuaj ne, i hanim

me dhëmbë këta rripa por tani, dhe ca vjet dhe...

YLLI — S'flet mirë, xha Veli... Pse kështu do të edukohet rinia, duke mos dhënë vet shembullin personal.

VELIU — Epo, çdo zanat do takat...

AZBIU — Gjersa e vendosëm ta bëjmë këtë punë do t'i lëmë mënjanë gjérat e tjera. Do ta prishim edhe gjumin e mëngjesit dhe do djersitemi më shumë.

AGIMI — A a, ju lutemi shumë. T'i kemi të ndara hesapet që në fillim, në qoftë se gjer më sot themi që kemi punuar, tani do të na duhet të punojmë katërfishin e saj që të mund të realizojmë zotimin e dhënë, se sot heqim plehun po nesër kemi mbjelljen e misrit, hapjen e tokave të reja.

MINEJA — Ashtu, ashtu të keqen Mineja. Shaka me shtetin s'bëjmë ne. Kemi dhënë fjalën.

DËFRIMI — Mua më mbajti pak kryetari...

AGIMI — (*I nxehur.*) S'ka këtu kryetari, sekretari! Justifikime mund të gjejmë sa të duash. Këttej e tutje s'do marrim parasysh asgjë. Erdhë në kohë dhe punove, mirë? Të lumtë... Përndryshe, ja ku e ke kolektivin, dil dhe jep llogari. Kështu! Të mos i mbetet hatri njeriut. Let'i kemi të hidhurat në fillim që të kemi bukën në fund.

DËFRIMI — Dakort, shoku Agim! Gabim kemi bërë!

HODOJA — (*Ironik.*) Po tani si do bëhet me ne? Do vritemi apo do falemi?

AGIMI — (*E kupton që tallet. Serioz.*) Ja ku i kini shokët. Ata e kanë në dorë t'ju pranojnë ose jo. (*Del.*)

VELIU — Pse? Gjer këtu paska vajtur puna?

AZBIU — Këtu, pos! Mirë jua bën agronomi se jeni mësuar keq me mua ju.

HODOJA — (Qesh.) Hë, more shokë, vendosni e mos na lini varur. Do na pranoni në punë apo të shkojmë të varemi vetë. (Afrohen të tre.)

AZBIU — Mos e merr me shaka ti, xha Hodo. Për sot ju pranojmë po herë tjetër... S'kemi ç'ju bëjmë.

VELIU — (Takohet.) Po si u gdhitë, more shokë?! Dali leni të takohemi një çikë se desh u vramë e u premë. (Ulet të çlodhet.)

AZBIU — Po thesin ku e ke ti, Veli?

VELIU — Ç'thes? S'na tha njeri pér thés.

AZBIU — Si nuk ju tha njeri? Po këtyre të tjerëve kush iu tha që e kanë marrë?

VELIU — Unë e mora vesh sikur do punonim ca me lopata e ca me krah...

AZBIU — Dhe ti zgjodhe lopatën.

VELIU — Lopatën po kë?

AZBIU — Po ti, xha Hodo, ku e ke thesin?

HODOJA — Të them të drejtën dhe unë si Veliu. Ja ku e kam lopatën. Në s'ju pëlqen kjo lopata ime, tjetër punë. (Qeshin. Vjen Agimi.)

AZBIU — Po këta, lee, pa na paskan ardhur si në dasmë me lugë në brez, pa thasë fare, o agromom.

HODOJA — Me lugë në brez pér atë pilaf ardhsh ti se ne kemi ardhur me lopata.

AGIMI — Si është puna? Kush s'e ka marrë thesin me vete?

VELIU — Unë.

HODOJA — (Dredh mustaqet rëndë-rëndë.) Edhe unë. Pse?

BEQIRI — Unë për vete ja ku e kam.

MINEJA — Edhe ne, a ta marsha, ja ku i kemi të mbushur.

VELIU — Ju ç'doni të thoni? Sy agronomi ka...

AGIMI — (Veliut dhe Hodos.) Ju e dinit që transpor-  
tin e plehut do ta bënim me krah?

VELIU — (Ironik.) Me krahë?! Çudi. Si s'e paskam  
dëgjuar se thasë në shtëpi kam boll.

AGIMI — Unë s'bëj shaka. Kemi ardhur përtë punuar, të punojmë!

VELIU — (Ironik.) Ashtu? Po punoni, more bir, punoni. Zaten për njerëz të tillë, punëtorë, ka pasur nevojë fshati ynë.

YLLI — Ti ç'do të thuash me atë fjalë, xha Veli? ...

VELIU — Atë që thashë, të keqen xhaxhai. Kishe ndonjë gjë ti ... ?

YLLI — Jo, jo, po sikur s'po flet drejt.

VELIU — Mirë, të keqen xhaxhai! Korrigjonani ju!  
Ne kaq dimë dhe kaq shitemi!

AGIMI — Unë do të bëj punën time, punën tuaj do ta bëni vetë.

HODOJA — Cila është puna që na takon ne? Pa na e thuaj ta dimë?

AGIMI — Kush nuk ka thasë të dalë këtej! (Défrimi  
ka thes po heziton të ndahet nga Veliu dhe Hodoja.  
Bën një hap por kthehet përsëri.)

AGIMI — Po ju? Ju sikur e kini thesin ... ?

VELIU — (Me inat.) Dëgjo, more djalë, se më duket ke qëndruar shumë asaj Tirane dhe i ke harruar zakonet tonë. Këtej kafshët ngarkohen. Njerëzit s'ka bërë vaki të ngarkohen.

MINEJA — (E nxehur.) Pse gratë s'i llogaritke në njerëz zotrote? Pse jot shoqe gomaricë është që ngarkohet dhe sot e kësaj dite!? Hajde, hajde

ulen i pak kërbishten edhe ju e mos na bëni shumë naze se iku ajo kohë kur na hiqeshit si kaposhë.

HODOJA — (Ironik.) Ç'pate, krushkë?

MINEJA — S'ka më krushkë, mushkë. Pa hëni, tun-duni nga vendi, se s'na vjen buka nga perëndia, po s'e nxorëm me duart e krahët tonë. Ka të drejtë djali. Unë kam marrë dhe fëmijën gjashë muajsh në djep në këtë të ftohtë e ju...

AGIMI — (I drejtohet Dëfrimit.) As ju nuk doni ta ngrini?

DËFRIMI — Po të na thoshte kryetari ...

YLLI — Ja. Kryetari s'është këtu. Të themi ne, të thonë shokët. (Heshtje.)

AGIMI — Shumë keq, xhaxha! (Veliut.) Qibarallëk me bukën!

VELIU — Ti, mor djalë, mos na shit teorira ne. Dje erdhe dhe kërkon të na dalësh ... Ne na kanë rënë qimet e kokës në këto të shkreta harca ...

AGIMI — (Rrëmben thesin dhe e hedh në krah.) Shkojmë, shokë!

BEQIRI — (I kap thesin.) Jo! Nuk të lëmë ta marrësh ti! Nuk bën ta ngrini ju! Mos na turpëroni kështu.

YLLI — (Hidhet t'ia marrë thesin; Beqirit vrazhdë.) S'të takon ty të na shpëtosh nga ky turp. Na takon ne, të gjithëve. (Agimit.) Lëshoje! Ma jep mua thesin!

AGIMI — Ja ku e ke thesin tënd, hidhe në krah dhe eja të shkojmë. (Mineja me Zarikën kanë ngarkuar thasët jashtë dhe dalin në skenë të ngarkuara. I pari niset agronomi, pas tij Ylli dhe Beqiri. Zarika, që del e fundit, i hedh një shikim të shpejtë Dëfrimit që e gozhdon në vend.)

DËFRIMI — (*Ngrihet në gjunjë.*) Zarika! Desha të bisedoj një çikë. (*Ajo ul kokën dhe ikën me nxitëm pas tyre.*)

HODOJA — Tëmën... picirukù!

VELIU — Dale, dale, se ka dava Janina. Në darkë do ta shkoqisim këtë punë me kryetarin. (*Dëfrimi merr thesin e lopatën dhe ngrihet.*) Ku shkxon ti??!

DËFRIMI — Ku po shkojnë të gjithë, xhaxha.

VELIU — Të qaka zemra për punë. Ik, se kanë dalë atje poshtë dhe të presin.

DËFRIMI — Nuk e pe... goxha agronom, djalë qyteti me universitet, e hodhi thesin në krah dhe u var poshtë, ndërsa ne... mirë tha: qibarllék me bukën.

VELIU — U turpërove ti?

HODOJA — More, që na turpëroi, na turpëroi gjer te mustaqet xhanëm, por s'kemi ç'të bëjmë.

DËFRIMI — Ç'të bëjmë?! Të ulim kurrizin e të punojmë, ja këtë të bëjmë. A erdhëm për të punuar?! (*Del.*)

HODOJA — Mirë thotë nipçja, vallahi.

VELIU — (*I nxehur.*) Hë, o burrani, kush ju ka ndaluar gjer tani. Unë ju mbajta këtu apo qëndruat vetë.

HODOJA — U bë ç'u bë, u bë si ka. Çohu edhe ti, o derëzi, e mos ngul këmbë si mushka. (*Me vete.*) Më bëri përshtypje dhe mua ai, Agimi. Si e hodhi ashtu thesin me bajga në kurriz? Tak fak! Është e çuditshme kjo rinia e sotme! Mirë thonë që rriten me një frymë tjetër! (*Veliut.*) Dhe ti, Velo vëllai, sikur e teprove pak.

VELIU — E te prova?

HODOJA — E teprove që e qelbe fare.

VELIU — Hë, fajin e pata vetë.

HODOJA — Vetë që ç'ke me të.

VELIU — (*I kthehet me nervozizëm.*) E ç'faj pata unë, të kam rixha, pa ma thuaj një çikë?

HODOJA — Ku e di unë. Ti vetë sikur the...

VELIU — E pata fajin unë që e ngacmova. Vë kokën në satër po qe se ai s'e hodhi thesin në krah për sedër.

HODOJA — E ç'rëndësi ka kjo? A e hodhi në krah?  
Eja!

VELIU — Ku të shkojmë?

HODOJA — Të hedhim një vallë në majë të plehut.

VELIU — Shko ti, shko, unë s'vij.

HODOJA — Hajde a derëzi. Ç'e zgjat e e bën tërkuzë këtë punë. Unë për vete vonë-vonë, po e pranova që bëra gabim dhe t'i vëmë kapak kësaj pune.

VELIU — Kur të puqet maja e veshit me majën e hundës!

HODOJA — Si të duash (*Bën të dalë.*) Në të marrtë malli për mua atje te kapica më ke. (*Del.*)

VELIU — (*Me vete.*) Tani me siguri do ta marrë vesh gjithë fshati këtë punë. Hë! Shumë i zgjuar doli qerratai. Po dhe unë... S'ma hëngri mendja se dò ta ngrinte gjithë atë alamet thesi në kurriz. Djalë mamake, thashë. Po, jam i sigurt që këtë gjë e bëri vetëm për të krijuar opinion. Paçka ky është fillimi. Do t'ia dëgjojmë dhe atij yneret se dardha e ka bishtin prapa.

(*Vjen Axhem. Është i djersitur nga udha. Ka hedhur xhaketën në njerin sup. Sheh Veliun që qëndron i ulur në anë të skenës.*)

**AXHEMI** — Njatjeta...

**VELIU** — Njatjeta, kryetar. (*Takohen.*) Të paska zënë vapa...

**AXHEMI** — E ç't'i bësh. Dola të shoh njëherë vendet ku do hapim tokë të re. Po ti këtu?..

**VELIU** — Ç'e nget, o kryetar. U bëra kaq sa më sheh e s'më ka qesëndisur njeri. Do më qesëndisi ai, i biri i Demkë Idrizit.

**AXHEMI** — Pse? Ç'të tha?

**VELIU** — E nisi që me mëngjes majë më majë. S'deshi të na pranonte dhe në punë.

**AXHEMI** — Se kini ardhur me vonesë?

**VELIU** — Jo ore, për nder, aty-aty ishim me shokët. (*Ndërkohë Lavdoshi me Minenë hyjnë në ske-në me thasë. Shkojnë t'i mbushin aty pranë.*)

**LAVDOSHI** — Njatjeta, kryetar!..

**AXHEMI** — Njatjeta Lavdo! dhe punë të mbarë!

**AXHEMI** — (*Veliut.*) Po përse atëherë ta ketë bërë. Të të ketë inat, s'e besoj. Ai s'ka disa ditë që ka ardhur dhe s'u ka lidhur puna që të mplekseshit me të. Ai të tha të mos punosh?

**VELIU** — Jo, ore kryetar! Kush e pyet atë! S'e kam as kryetar as brigadier që të më komandojë. (*Me nervozizëm.*) U bë ai të më komandojë mua!

**AXHEMI** — Se ç'llafe kini shkëmbyer s'e di por nga ç'shoh them që ti s'ke bërë mirë që je ndarë nga shokët. Edhe sikur të kesh të drejtë. Bëj punën tënde...

**VELIU** — Pse, ti thua që s'paskam të drejtë?

**AXHEMI** — Jo ore, jo. Por nga ç'shoh ti qëndron duarkryq e atë tjetrin e pashë të varej poshtë me thes në krah.

**VELIU** — Hë! E bën për t'u dukur, o kryetar. Ti i

kupton këto gjëra. Ja, këtu do jemi. E bën pér të më diskredituar mua.

**LAVDOSHI** — (*Ndërhyj*) Më falni që ndërhyj dhe unë. Ai të diskreditoi duke hedhur thesin në krah ti e diskreditove me llafe.

**VELIU** — Lavdo, të lutem mbaj gojën!

**LAVDOSHI** — Pse s'ia more thesin ti nga krahët e t'i thoshe: lëre këtu se s'të takon ty, po më takon mua ta ngrë?! Hë? Këtë po të kishe bërë të kishte lezet dhe fjala. Jo, jo kështu. A kemi ardhur pér të punuar apo pér të tundur zinxhirët. Jemi përpara një situate të jashtëzakonshme. O e nxjerrim bukën në vend këtë vit, o turpërohemti të gjithë para partisë.

**VELIU** — Mirë, o Lavdosh. mati dhe ti njerëzit me hijen e mëngjesit. Po mos na del dhe ky si ai agronomi i parë. Kështu e nisi dhe ai, sikur do ta nxirri kooperativën nga situata por s'kaluan as dy vjet dhe ç'bëri? S'la gurë pa lëvizur pér t'u kthyer prapë andej nga kishte ardhur. Me miq e me raporte mijekësore gjersa dhe ju vetë e latë të sikterrisej këtej.

**LAVDOSHI** — Ai që kërkon të iki prapa diellit të vejë. Me zor nuk mbajmë njeri.

**AXHEMI** — Po zaten një njeri që s'e ke pér punë përsë ta kesh. (*Mineja i flet Lavdoshit të marri thesin. Lavdoshi ikën.*)

**VELIU** — Po Dëfon ju e vonuat sot?

**AXHEMI** — Po. E mbajta pak unë. I thashë dhe Azbiut po të them dhe ty. Më tepër se 3-4 veta mos më ejani sonte. Ja, Azbiu, ti, Dëfua, mund të merrni dhe ndonjë grua dhe kaq. Dorëzënie po bëjmë. Pa ceremonira.

**VELIU** — Pa prit, se këtu nisi dhe sherri, që the ti. Se

Dëfrimi i tha që u vonova se më mbajti kryetari, por ai ia priti: «S'njoh unë as kryetarë, as sekretarë ...

AXHEMI — Kështu tha...?

VELIU — Për ndër po. Po ç'njihka zotëria e tij në fshat: agronomin? Janë ca të rinj si ky që marrin një copë diplomë dhe u duket vetja që janë mbi të gjithë. Paçka se do i ulet hunda dhe atij.

AXHEMI — Mirë mirë. Ti shko shih punën!

LAVDOSHI — (*Vjen përsëri me thes të boshatisur. Sheh në skenë Veliun dhe Agimin.*) Ti Veli...  
Seç na u akove qëparë.

VELIU — Jo, o sekretar. S'u ankua njeri. Mos i keq-interpretoni gjérat. Më pyetët, ju përgjigja.

LAVDOSHI — S'është mirë të flasësh prapa krahëve. Tani sa u ankove për Agimin që të ka qesëndisur. Ja ku jemi, midis shokësh, Pse t'i mbajmë mëri njëri-tjetrit? Ta shoshisim këtë punë e të kërkojmë ndjesë po të jetë e vërtetë; po të mos jetë e vërtetë, të bëjmë autokritikë që marrim të tjerët nëpër gojë dhe ta mbyllim.

VELIU — Unë ato që kisha i thashë. (*Lavdoshit.*) Je sekretar dhe s'të ka hije t'i hedhësh dru zjarrit. Tani jemi në punë. Po të kesh gjë më thirr në darkë në zyrë të sqarohemi.

LAVDOSHI — Pse ta bëjmë te zyra. Ta rrahim hekurin në vend, sa është i nxeh të. Si thoni, shokë? (*Zëra që aprovojnë.*) Jemi në fushatën e bukës dhe gjëra të tillë sjellin pasoja.

AGIMI — Ç'është e vërteta ne shkëmbiyem ca llafe përhir të punës...

AZBIU — Jua them unë me dy llafe. A erdhëm për të punuar, more vëllezër? Bujrum të punojmë.

Këta shokët jo vetëm që na erdhën si kalanderë  
dhe me vonesë por na tani dhe llafe. (*Merr lo-  
patën dhe mbush thesin e Zarikës.*)

VELIU — Për thasët dhe vonesën e pranoj gabimin  
paçka se djali, në mënyrën si na u kacaros, tre-  
goi që i mungon edukata dhe respekti për më  
të moshuarit. Po ajo fjalë që hodhi dhe që ju të  
gjithë e dëgjuat ç'qe?

AZBIU — Cila fjalë?

VELIU — Ja, që s'njoh as kryetarë as sekretarë.

AGIMI — (*Nxiton.*) S'është e vërtetë! S'thashë ashtu!

VELIU — Si s'qenka e vërtetë. Hë, fol o Dëfo, se ty  
t'u drejtua për këtë. Akoma s'ka hedhur këm-  
bën në fshat dhe s'njihka as sekretarë as krye-  
tarë. Ku kulot ti, në ç'qeveri? E nga na vjen ti,  
nga hëna?

LAVDOSHI — (*Veliut.*) Ule pak zërin e mos u rrëmbe!

ZARIKA — (*Veliut.*) Je burrë i moshuar e s'të ka le-  
zet të shtrembërosh fjalët e tjetrit.

VELIU — Ja ku janë. Le të flasin. Hë, more shokë,  
flisni. A nuk tha kështu?

ZARIKA — Jo. Nuk tha ashtu. Ja unë isha vet dhe e  
dëgjova me veshët e mi. S'tha njeri s'njoh as  
kryetarë as sekretarë. Por tha s'ka këtu se-  
kretari . . . kryetari . . . Dhe në kritikoi, u kriti-  
koi juve për justifikime dhe as babanë as Lav-  
doshin. Le të flasin shokët.

ZËRA — Ashtu, ashtu tha.

DÉFRIMI — Unë nuk u justifikova, por fakti është  
fakt. I thashë se më mbajti kryetari.

ZARIKA — E në të mbajti babai gabim ka bërë. Po  
të kishte gjë për të sqaruar me ty le ta sqaron-  
te më vonë . . .

DÉFRIMI — (*Zarikës.*) Po ti ç'e ke atë që e mbron?

ZARIKA — (*Qesh.*) Ç'e kam? Asgjë. Pse duhet ta kem patjetër diçka që ta mbroj?

DËFRIMI — Jo! Thashë!

ZARIKA — Pse ti meqë e ke xhaxha xha Veliun mund ta mbrosh dhe kur s'ka të drejtë e kur shtremberon fjalët e tjetrit?

DËFRIMI — Kush tha se e mbroj? Po, sidoqoftë një çikë takt duhet të kishte. Se mirë unë që jam moshatari i tij. Po xhaxhai është më i moshuar, si të thuash është babai i tij. (*Ka ngarkuar thesin me litar, del.*)

AGIMI — (*Veliut.*) Unë e kisha fjalën tek justifikimet. E tha dhe Zarika. Si do të flisja unë ashtu për xha Axhemin dhe Lavdoshin. Unë xha Axhemin dhe Lavdoshin i çmoj dhe i respektoj si njerëz me eksperiencë nga të cilët unë do të përpinqem të përfitoj sa më shumë. Ndoshta jemi keqkuptuar, xha Veli. (*I afrohet, i hedh dorën në sup.*) Sidoqoftë, të më falësh. Në fola pak ashpër, gabim kam bërë po s'kisha asnje qëllim të keq, veç çështja është që ta vëmë njëri-tjetrin në pozita pune.

VELIU — Jo, more bir. S'ke faj ti. Se dje erdhe e s'na njeh akoma mirë...

AGIMI — (*I zgjat dorën.*) Të kërkoj të falur.

VELIU — (*I shkrifëruar.*) Jo, ore jo: Ç'falje të më kërkosh mua ti. Falje na takon ne të të kërkojmë ty që s'ishim në rregull...

LAVDOSHI — (*I gëzuar, Veliut.*) Hë më të lumtë. Tani e bëre si burrat. Me zorr, me zorr por e shkrepe në fund. Zaten, kjo puna e sedrës, kjo na kërcënon të gjithëve. Se s'e përtypim dot kritikën, sikur na shpon si hosten e hidhemi përpjetë. Po ç't'i bësh dhe kininua

farmak éshtë po kur e do nevoja do ta pimë. S'kemi ç'bëjmë. Besoj s'bëmë keq që hën-grëm pak kohë me gjëra të tilla, nga ca gjëra të tilla na lindin të mëdhatë, ca të krisura që hajde t'i ngjitësh pastaj. Hajde Veli... Haj-deni tani, shokë, në punë. (*Veliu merr lopatën dhe vazhdon të mbushë thesin. Të tjerët lëvizin, shpërndahen. Zgjat thesin për ta mbushur Zarika*).

VELIU — Dhe ti, moj nuse, kundër *xhaxhait*?!

ZARIKA — (*E nervozuar.*) S'jam nuse, po jam Zarika. Dhe se ç'ka biseduar xha Azbiu me babanë, ta dish, as më intereson fare. (*Ndërkohë në ske-në ka hyrë Axhemini me Azbiun.*)

AXHEMI — Si, si the, moj, pa përsërите dhe një herë?!

ZARIKA — Atë që thashë, baba!

AXHEMI — (*S'përbahet.*) Këput qafën!.. Edepsëze!

YLLI — (*I del përpara.*) Lëre, baba. E kemi biseduar një herë këtë punë. Me zorr s'e detyron njeri. Fundja ajo do martohet. S'martohemi as unë, as ti.

DËFRIMI — (*I shkon pranë.*) Xha Axhem, mos u shqetëso... Zarika ka të drejtë. U nis që në fillim keq kjo punë. Po nejse... Nuk ndodhi asgjë.

ZARIKA — (*E gjëzuar.*) Faleminderit Dëfrim! S'e prisja nga ti...

DËFRIMI — (*Ftohtë.*) E ku më njeh ti mua? As ke dashur të më njoħeš. Sa herë kam dashur të bisedoj ti je fsheħur.

ZARIKA — E ç'të bisedonim, kur s'kam ndier asnjëherë asgjë pér ty? Mos të të vijë keq...

DËFRIMI — (*Hidhur.*) Keq?! Përse të më vijë keq...

As unë s'kam ndier ndonjë gjë të madhe për ty por me që m'u qep babai...

AZBIU — (*Dëfrimit.*) E, e, Embëlsirat i ha djali aguridhet babai. (*Axhemit.*) Ne keq përl nuse s'kishim mbetur, se plot vajza të mira ka fshati ynë. Zgjat dorën e zgjidh. Dhe djalin të mirë e kemi. (*Zarikës.*) Paçka se syri na vajti te ti.

Por, meqë e bëre kështu s'të kemi faj... ne për të mirë u përpoqëm...

LAVDOSHI — (*I gëzuar.*) Vazhdoni punën, shokë. Zëreni se nuk ndodhi asgjë. (*Njerëzit shpërndahen. Largohet dhe Zarika me Yllin. Azbiu bën të dalë.*)

AXHEMI — Azbi, të desha pak.

AZBIU — E ç'do më thuash më, o kryetar. Që mos kem gajle se do të rregullohemë përsëri midis nesh?

AXHEMI — Jo, jo. Po prit pak!

AZBIU — Faleminderit! Për sot u ngopa dhe më te projoi.

## NË PARASKENË.

(Azbiu-Beqiri)

AZBIU — Hë, si u bë?

BEQIRI — Lere, lere. Kam shpëtuar për qime.

AZBIU — Jo, more! Po të paktën, a mbarove punë?

BEQIRI — Ç'punë, a derëzi. Nuk më thua shyqyr që shpëtovë vetë. E kujt ia priste mendja se pikërisht në atë orë e në atë minutë do të dilte tek stallat Manushaqja e Hodos me Zaron.

AZBIU — Ptu, djalli ta marrë!

BEQIRI — Shyqyr që i ndjeva hapat e tyre, dhe pësht, e dola nga dritarja.

AZBIU — Po dritaren e mylle mirë?

BEQIRI — Po, po, atë e mylla, po kam frikë mos nga nxitimi më është derdhur gurkali udhës.

AZBIU — Nejse, ajo s'prish shumë punë. Gjatë natës do të bjerë shi patjetër, me gjithë këto vetëtima që bien, dhe e lan. Por unë kam frikë, se ardhja e tyre mos nuk është rastësi... Vure re mirë, mos të ka parë njeri kur hyre brenda.

BEQIRI — Jo, për nder! Ruajta gjatë aty pas murit gjersa u sigurova mirë që s'pipëtinte frymë njeriu, pastaj vendosa dhe u hodha brenda. Pastaj,

nga ta kenë marrë vesh? Përveç në të dyve  
nuk e dinte njeri. Kështu apo jo?

AZBIU — Sidoqoftë, duhet menduar dhe e keqja.  
S'ma ha mendja të mos ketë diçka në këtë  
mes...

BEQIRI — Po vjen rrugës Hodoja.

AZBIU — Ashtu! Ik ti... Mos na shohë bashkë.

BEQIRI — Natën e mirë, pra!

AZBIU — Natën e mirë!

(*Azbiu ka ndaluar në mes të rrugës dhe pret Hodon me pretekstin se gjoja s'i ndizet çakmaku nga era.*)

HODOJA — (*Hyn në skenë.*) Të qenka mbaruar benzina, o Azbi vëllai.

AZBIU — Hodo, qysh më je?

HODOJA — Mirë, o mirë, ja ta ndez unë me uror. Ky i shkretë, ashtu primitiv, po nuk të lë asnjëherë në baltë, ama, si këto çakmakët që mbani ju.

AZBIU — (*E ndez.*) Ke të drejtë. More, si e kini atë të voglin tani me shëndet?

HODOJA — Mirë, o mirë! — I rrit vetë havaja e malit.

AZBIU — Shyqyr, shëndoshë të jenë. Se pashë tanë Manon tënde me një tjetër që zbriti poshtë dhe më shkoi mendja mos shkonte të thërriste mjekun.

HODOJA — (*Qesh.*) Jo, a derëzi, po do kenë pasur merak për lopën larë se ka disa ditë që s'është mirë dhe dojenë kthyer prapë andej nga stalla.

AZBIU — (*I qetësuar.*) Ashtu, ashtu do të ketë qenë. Është merakleshë e madhe për punën, i lumtë.

HODOJA — E po ti e di vetë, kafsha është si fëmija pa gojë. Të qan, po s'e di së ku i dhemb.

AZBIU — Ashtu, ashtu. (*Dalin.*)

## PJESA E DYTE

### Tablo e IV-të

Në sfond tarraca të reja malore, ku jeshilon gruri i ri. Më lart maja malesh me dëborë. Është mesditë maji dhe brigada e tretë është ulur nën hijen e një arre duke ngrënë drekë. Në degët e arrës janë varur trasta, xhaketa, pagure. Mineja, që ka marrë djepin në arë me gjithë foshnjën, është duke i dhënë gji.

**HODOJA** — Vapë e madhe. (*Fshin djersën me shami.*

(Défrimit.) Më jep pak paguren tënde se përnder do të pëlcasim sot nga të nxehtit.

**VELIU** — Shumë shpejt erди dhe kjo djallë verë, pa mbaruar shirat u nxeh dhe guri. (*Paguren e merr Veliu.*)

**DÉFRIMI** — E mjaft, xha Veli, e kemi për gjithë ditën.

**MINEJA** — Pse, o brigadier? Ti sikur the që gjer në drekë, apo t'u ndërrua mendja...

**AZBIU** — Avash, avash, xhare Mine. U lodhët? Pushon!

**VELIU** — Për nder, o brigadier, dhe kjo s'është parë e dëgjuar, të prashitet gruri në vend të misrit

që s'mbiu. Vetëm këtij agronomit tonë i pjell mendja të tilla gjëra, apo ka dhe të tjerë kështu?

AZBIU — Prit, o Veli, mos u vjas!

VELIU — Nuk vjaset njeri, o jo, por kësaj i thonë: «Prit gomar të mbijë bar». More, të na rroj agronomi, pa misri këtë herë na e mori uratën.

MINEJÀ — Agronomi të na rrojë vërtet e ta kemi me jetë, e sa për misrin, që thua zotrote, mirë të thotë brigadieri që të mos vjasesh. Po ti, zaten, tërë jetën zi të ka parë syri.

VELIU — Moj, c'i do fjalët e tepërt. Misrin ku ma ke? Se për fjalë jini të gjithë të vetmit, të mirrni në qafë me premtim e zotime, por hallbu që me fjalë pa kokrra s'ngopet njeri sot, sot jemi në 12 qershor, misri duhet të kishte dalë 12 ditë sot. Këtë më shpjego ti, në je e zonja.

AZBIU — Misri është vonuar se është bërë një gabim i vogël në thellësi. Dhe këtë e dini, që nuk është parashikuar mirë thellësia e vlagës. Po s'është kjo, shokë, se kemi një zakon, po që për gabimin e të tjerëve e ngremë zërin në majë, për gabimet tona veshin e bëjmë të shurdhër. Në dy parcelat tona është konstatauar që ka kalbje të farës.

HODOJA — Këtë e thotë agronomi. Të dalë njëherë misri në sipërfaqe pa kollaj, e shohim dhe këtë.

BEQIRI — Aman, more shokë, c'po bëhet kështu?! Po na e zini bukën në fyt, në mëngjes në mbledhje, në arë mbledhje, vijmë të hamë një çikë bukë e të na shkojë në stomak, përsëri mbledhje, shkojmë në shtëpi përsëri mbledhje, c'bëhet kështu.

AZBIU — Mbledhje bëhet. Pse s'të pëlqejnë mbledhjet ty?

BEQIRI — Edhe duke ngrënë bukë?!

AZBIU — Edhe në gjumë. Këto janë problemet tona e do mirremi ditë e natë me to. Ty në qoftë se nuk të pëlqen mos rri me ne, veçohu, kur të hamë bukë ne.

BEQIRI — Mirë xhanëm, mirë. Më falni se ndoshta e teprava pak.

AZBIU — S'e ke tepruar pak po shumë. Të zikan bukën në fyt mbledhjet tona zotrote. Mirë të ta bëjmë. Dhe këtë fjalë që lëshove këtu do ta shohim mirë s'do ta lemë me kaq.

VELIU — Hë mo, se s'e tha me ndonjë qëllim.

AZBU — Ku e di ti që i del avokat mbrojtës?

VELIU — Jo, kot thashë.

AZBIU — Epo, kur s'e dini mbylle gojën atëherë!

MINEJA — Mos u zini! Kush do një thelë byrek?

HODOJA — Byrek? Po fol, moj e uruar. (*Shkon pranë saj.*)

MINEJA — Të pëlqen?

HODOJA — I mrekullueshëm. Të lumshin duart dhe marsh një nuse për djalin jo më të mirë se ç'je vet!

MINEJA — U më marsh të keqen! (*Në skenë hyjnë Axhemini me Lavdoshin.*)

AXHEMI — Mirëdita dhe ju bëftë mirë!

ZERA — Bujrum!

(*Azbiu çohet dhe i takon. Cohen dhe të tjerë në shenjë respekti.*)

AXHEMI — Uluni, uluni! Që të mos i biemi rrrotull muhabetit. (*Nxjerr letrën.*) E shihni këtë? Kjo letër na vjen nga komiteti i partisë për ta shqyrtuar në brigadën tuaj. Letershkruesi

mund tē jetē i brigadës suaj, payarësisht që s'e ka vënë emrin por poshtë shkruan nga brigada e tretë.

HODOJA — Ashtu? S'dimë gjë.

MINEJA — Ç'thotë ajo letër? Na e lexo ta dimë.

LAVDOSHI — S'është nevoja tē lexohet. Përbajtjen po jua them unë me dy fjalë. Letërshkruesi shkruan pér punën e misrit që s'ka mbirë, pér gabime tē shokëve drejtues. Merr nëpër gojë marrëdhëniet shoqërore tē dy tē rinjve: Agimit dhe Zarikës; sekretarit dhe zëvendëssekretares së rinisë, edhe ndonjë gjë tjetër që nuk është nevoja tani pér tani t'jua themi.

HODOJA — (*Ngrihet i indinjuar.*) Të dalë i zoti i letrës, kush e ka shkruar dhe kush e ka autorizuar atë shok tē flasë në emrin tonë e tē na njollosë emrin e brigadës.

DËFRIMI — Me leje. Nga e dini ju që letra është shkruar nga një pjesëtar i brigadës sonë? Se shkruan poshtë brigada e tretë? Ky nuk është fakt. Ai që e ka shkruar ashtu siç ka dashur tē maskojë emrin, mund tē ketë dashur tē maskojë dhe skuadrën ku bën pjesë.

VELIU — Kini ardhur tē analizoni letrën apo tē gjeni cili e ka shkruar atë. Në kini ardhur pér letrën hajde tē diskutojmë pér tē. Pse s'ka tē drejtë dhe si është e vërteta.

AXHEMI — Të drejtë ka Veliu.

VELIU — Të marrim punën e misrit. U mboll, harxhuam mundin tonë edhe farën, po ku është se? Mirë që e nisëm me trompetë këtë punë po më duket se do ta mbarojmë me daule. Që tani duhet parë kjo. Sa kohë kemi mun-

dësi të mbjellim përshëri farën e misrit? Se dhe koha s'pret. Këtë ju e dini më mirë se unë, xhanëm... Unë kot ua them.

LAVDOSHI — Mos u shqetëso, Veli, për këtë punë kemi ardhur, dhe s'ikim pa i shoshitur mirë gjërat. Ka ndonjë që pranon se kjo letër është shkruar me dijeninë e të gjithëve.

ZËRA — Jo. S'është e vërtetë një gjë e tillë. Këtu gënjen ai që e ka shkruar...

LAVDOSHI — Pra, jemi të gjithë dakort që i zoti i letrës nuk del hapur. Ne e diskutuam dhe mbrëmë në organizatë. Tani të marrim punën e misrit, që s'ka mbirë akoma. Këtu është fjala për gjëra të paverifikuara. Që fara e misrit është e shëndoshë, kjo është e verifiuar nga ne.

AXHEMI — Ndërsa, ç'rendiment do të japë kjo farë këtë s'e di asnjeri. As agronomi vetë s'e parashikon dot që në bimë.

LAVDOSHI — Ndaj, shoku Veli, dhe për këtë, letër shkruesi, është nxituar dhe ka thënë gjëra të pasakta. Ndërsa në pikën e tretë unë them se ajo është shpifje me brirë, se Agimin e njohim të gjithë për djalë të ndershëm dhe punëtor. Ky është mendimi im dhe i Axhemit, po të ketë ndonjë që mendon ndryshtë le të ngrihet të flasë.

ZËRA — Agimin e njohim. Këtu do të ketë ndonjë inatç i që shpif me qëllim...

VELIU — Pse më drejtoshesh mua?

LAVDOSHI — Ty e të gjithëve. Kushdo që të jetë, ai midis jush është dhe më dëgjon.

MINEJA — Të dalë vetë kush është!

**BEQIRI** — Me leje? Ju vete dyshoni te ndonjë nga ne?  
Më konkretisht.

**LAVDOSHI** — Po, dyshojmë!

**BEQIRI** — Te kush?

**LAVDOSHI** — Te ty i pari, te Veliu ... te Dëfrimi ..  
(*Zëra, zhurmë.*)

**DËFRIMI** — (*Ngrihet në këmbë me rrëmbim.*) Tek  
unë?!

**LAVDOSHI** — Po. Dhe te ty. Ky është mendimi im  
personal.

**DËFRIMI** — Mendimin tënd personal mbaje për vete.  
Je sekretar dhe s'të lejohet ty të akuzosh tjetrin  
pa baza. Ja ku është dhe xha Axhemini, pavarësisht  
nga ajo që ndodhi dhe që ju e dini  
të gjithë, Zarikës as i kam borxh as më ka. Të  
dali këtu në shesh të burrave kush është dhe të  
japë llogari para masës se ç'ë ka shtyrë atë të  
shqetësojë partinë me këtë letër. (*Ulet. Zhurmë.*)

**BEQIRI** — (*Ngrihet në këmbë.*) Pyetjen rastësisht s'e  
bëra. E dija që do ta vinit gishtin edhe mbi  
mua si për forcë zakoni. Jam i mallëkuar nga  
fati që kur linda nën atë strehë aty, që sa herë  
të ndodhë diçka, të mblidhen rrëth meje sytë  
hetues të shokëve të mi. Mos ndodhtë ndonjë  
gjë së përgjigjja është gati: Bequa! Patjetër ai  
do të ketë gisht në këtë punë.

**LAVDOSHI** — (*Vrazhdë.*) Po, po. Ti rastësisht nuk  
pyete dhe unë rastësisht nuk t'u përgjigja. Gjëra  
rastësisht s'kanë ndodhur dhë s'ndodhin te  
ne. Ndaj ule zërin se s'të ka persekutuar  
njeri, përkundrazi, ti jeton në kolektiv me të  
drejta të barabarta, njësoj si të gjithë. Por sytë  
nuk kemi për të t'i ndarë. Ta dish mirë këtë. Le

që ti e di, po në s'të pëlqen s'kemi ç'të të bëjmë.

**BEQIRI** — (*I revoltuar.*) Në urreni njëherë tim atë, unë duhet ta urrej një mijë herë për këtë njollë që më ka lënë.

**HODOJA** — Flet kështu se nuk është koha juaj, se po të ishte ajo kohë do flisje me ne ndryshe.

**BEQIRI** — Flas kështu se kështu e ndiej këtu, thellë në zemër. Flas kështu se jo vetëm ju, por edhe unë e dua këtë parti dhe këtë pushtet njësoj si ju. Biri i saj jam edhe unë. Partia nuk thotë që kusuret e prindërve t'i vuajnë fëmijët e tyre.

**LAVDOSHI** — S'kemi mbetur të na mësosh ti se ç'thotë partia për këto gjëra.

**DÉFRIMI** — Ti gënjen. Se ti nuk e urren atë. Përkundrazi. Po të duash po të kujtoj një bisedë të tërë me Bardhën ka ca kohë. Yt atë paska qenë njeri i kulturuar se dinte gjuhë të huaja. Yt atë ka shetitur gjithandej, ruani dhe ca fotografi të bukura nga shëtitjet e tij andej këtej. Atéherë, si e urreke ti tët atë? Si egoist që je, se të paska shkaktuar fatkeqësi?, Se si njeri nuk të kemi dëgjuar të shashë asnjëherë.

**BEQIRI** — Dyshoni, fundja, dyshoni! Hajt, forca, nuk ju ndalon njeri. Aq më bën se dyshoni tek unë. Vetë a jam në rregull?...

**MINEJA** — (*Axhemit.*) Kam një propozim: ja ku jemi, ai që e ka shkruar gjendet me anë të shkrimit. Na jipni nga një copë kartë dhe na i merrni shkrimet.

**AXHEMI** — Fjalët janë të një të rrituri, dora është e një fëmije.

**MINEJA** — Pika... Fusin dhe çiliminjtë e i mësojnë të gënjejnë. Ç'prind është ai??

**AXHEMI** — Pse ta kapim veshin nga prapa kokës? Ai që e ka shkruar éshtë këtu. Të ngrihet vetë e të thotë ballëhapur ç'ka për të thënë. E po të ketë të drejtë ja ku jemi të gjithë, xhanëm, t'i japim të drejtë. Kështu, more shokë, a po flas gabim? Si thua ti, Veli?

**VELIU** — (*Nga vendi.*) Ç'kërkon nga unë, o kryetar?! Je adresuar gabim, s'shkruan letër Veliu!

**AXHEMI** — Po kush ta pret mendja ty?

**VELIU** — Ku di gjë unë. Gjejeni! E mira do të qe të ngrihej vetë.

**AXHEMI** — Ashtu themi edhe ne.

**VELIU** — Veç një gjë, mirë tha Défrimi: kur ta vini gishtin mbi një person duhet të mendoheni mirë, se përakuza të rreme ka edhe gjyqe.

**AXHEMI** — Nejse, problemi éshtë i qartë. Rëndësi ka që ato që thuhen në letër s'janë të vërteta. Me ndjekjen e saj na takon të mirremi ne.

**METIA** — Pa dalë në shesh si qëndron e vërteta dhe kush éshtë i zoti i letrës s'luajmë nga vendi. Kush éshtë dakord të vazhdojë mbledhja? (*Të gjithë ngrenë dorën.*)

**LAVDOSHI** — Atëherë vazhdojmë, në interes të punës éshtë edhe kjo.

**HODOJA** — Po mirë, vellezër, si do vejë kjo punë? Sa parashikohet që të presim? Kështu siç e kemi nisur mund të iki pasditja e të na zerë nata dhe mos të dalë gjë në shesh.

**LAVDOSHI** — Këtë gjë e ka në dorë kolektivi.

**METIA** — Kolektivi s'lëviz që këtej, or byrazer, pa u ngritur vetë ai që e ka shkruar letrën dhe të thotë pse e ka bërë, për ç'arsye. Se ka të ngjarë që këtu të kemi edhe punë armiqësore. Se

punë armiqësore është edhe një letër anonime që merret me shpifje.

**AXHEMI** — Ka rëndësi të dalë vetë, jo ta nxjerrim ne, në të mirën e tij është. Si thua ti Beqir?

**BEQIRI** — (*I shqetësuar.*) Ashtu është.

**AXHEMI** — Si ashtu?

**BEQIRI** — Ashtu siç thatë ju, shoku kryetar.

**AXHEMI** — Ne do të mbledhim edhe fletoret e fëmijëve dhe këtë gjë e verifikojmë ndryshe, po pse t'i hyjmë atij avazi,

**DËFRIMI** — Me leje. Të flasim hapur. Ti Veli më ke thënë të shkruaja letër për Zarikën që shoqërohet me agronomin po unë s'pranova. Të flasim hapur, është kështu, apo jo?

**VELIU** — Jua thashë edhe njëherë, që letrën s'e kam shkruar unë! Gjejeni se kush e ka shkruar. (*Dëfosh.*) Dhe ti, bir i xhaxhait, po e bën si në atë këngën: «nga sevdaja e dashurisë, unë vrava xhaxhanë».

(*Ndërkohë vjen Agimi me Zarikën. Axhemit i qeshur.* Misri nesër duhet të çajë tokën dhe duhet të dalë në sipërfaqe.)

**AGIMI** — Mirëdita dhe mirë se rrini! (*Axhemit i qeshur.*) Misri nesër duhet të çajë tokën dhe duhet të dalë në sipërfaqe.

**LAVDOSHI** — Ashtu!? Ky lajm na takon të gjithëve.

**AGIMI** — Vetëm në ato dy parcelat konstatuam se ka kalbje. Faji mund të jetë dhe i imi por unë mendoj që këtu ka më tepër se pakujdesi, sabotim. Kalbja ka ardhur nga ujitja e tepërt.

**AZBIU** — Ujiten ua kemi bërë njësoj si dy parcelave të tjera. Ti vetë na ke qëndruar te koka, tërë ato ditë, që ujitja të bëhej mirë.

AGIMI — Qofsha i gabuar por mendimi im éshtë ky: dikush ka hapur vijen e ujit natën dhe e ka lënë të derdhej në këto dy parcela.

AXHEMI — Je i bindur pér këtë?

AGIMI — Shumë i bindur.

AXHEMI — Atëherë çështja éshtë më serioze se puna e letrës. Personi éshtë në mes tonë.

LAVDOSHI — Personi do të gjendet se s'bën. Tani le të mendojmë si t'ia bëjmë që dhe në këto dy parcela të mos kemi dështim.

AGIMI — T'i mbjellim përsëri, sa s'është vonë. (*Zëra që aprovojnë*)

AXHEMI — Shumë e drejtë. Ne do t'ju sjellim pér ndihmë dhe brigadën e dytë.

AZBIU — Jo, shoku kryetar! Kushdo që të jetë ai që e ka bërë, faji na takon të gjithëve. I takon vetë brigadës sonë ta shlyejë këtë, pa forca të tjera.

AXHEMI — Koha éshtë tepër e shkurtër. Në qoftë se s'mbarojmë gjë pasnesër s'kemi siguri. Ç'thoni ju, shokë? C'thua ti, Agim?

AZBIU — S'ka ç'e zgjasim. Të fillojmë që tani nga puna.

AGIMI — Dhe të vendosim të gjithë, që këtu, që të mos kthehem i sonte pa mbaruar punë me parcelën e parë. (*Zëra që aprovojnë*)

LAVDOSHI — Të dërgohet një njeri në fshat e të lajmërojë familjet që të mos bëhen merak. Atëherë, kështu siç jemi të gjithë së bashku, përpëra drejt Arës së Gjaqeve! (*Ngrinen të gjithë*)

## Tabloja e pestë

*Bie shi. Vetëtin e bubullin. Midis dy portave të jashtme të Agos dhe Axhemit vijnë Zarika me Agimin me shata në krahë.*

*Agimi vrapon dhe qëndron nën strehën e portës. Zarika vjen dhe qëndron dy tre hapa larg tij. Ka ardhur zbathur nëpër shi. Flokët i janë qullur. Sandalet i ka në dorë. Qesh pakuptim. Është e gjëzuar.*

AGIMI — Zarikë! Mos qëndro në shi.

ZARIKA — (Duke qeshur.) Jo, do të rri.

AGIMI — Mirë atëherë, rri.

ZARIKA — Sonte sepse kam dëshirë të vrapoj nëpër shi. Pse thonë që shiu të ngjall trishtim? Gjithmonë kam menduar se shiu ka diçka të gjëzueshme në vetvete. Një shushurimë gazmore që të ngazellen e të grish të ecësh, të ecësh kuturu pa ditur se ku të çojnë këmbët. Po ti?

AGIMI — Ti je romantike.

ZARIKA — Kur ishim të vegjël gjithmonë kur binte shi dilnjm me Yllin dhe e bënim se kush do të qëndronte më shumë nën strehën e shiut dhe gjithmonë unë fitoja. Po ty s'të bën përshtypje aspak shiu...

AGIMI — Po të vazhdojë dhe' nja dy orë kështu si e ka nisur do të na rrëzojë të gjithë grurin përtokë.

ZARIKA — Vërtetë? S'më shkoi në mendje fare. (Dëgjohet zëri i Axhemit: Zarika!) Urdhëro, baba!

AGIMI — Natën e mirë, Zarika!

ZARIKA — Mirupafshim!

AXHEMI — (Ka dalë tek porta. Zarikës egër.) Po ti, pse kaq vonë?

ZARIKA — Erdhëm ngadalë baba, duke kënduar e duke bërë shaka. Me ne ishte dhe Agimi. E more vesh? Në Kakomë misri kishte buisur mbi tokë. Dhe në tarracat e reja gruri ishte rritur goxha, vende-vende na u duk se kishte filluar të zverdhej. Së shpejti do të kemi korrjet.

AXHEMI — Vetëm u ktheve?

ZARIKA — Jo baba, me Agimin. (*Sheh që i ati është i nervozuar.*) Dhe me shoqet e tjera... Po ti pse pyet? Ç'ke kështu baba? Mama, si ka qenë gjysh Agoja sot?

(*Në skenë hyn Merushja.*) Po gjellën ia bëre gati?

MERUSHJA — E bëra dhe ia çova vetë.

ZARIKA — Pse, moj mama? Unë nuk jam vonuar. Si gjithë herët e tjera kam ardhur.

AXHEMI — Gjellën që sot e tutje s'ke për t'ia çuar ti xha Agos dhe në atë shtëpi s'do të shkelësh më.

ZARIKA — Pse, baba?

AXHEMI — Atë e di unë! (*Sheh motin.*) Ta marrë djalili, ta marrë, dhe këtë shi. Nga na erdhi tani.

ZARIKA — Pse s'flet me mua hapur, baba? Çfarë kam bërë që nuk duhet të shkel më në atë shtëpi?

AXHEMI — Ç'paske bërë! Ke bërë atë që s'e ka bërë asnjë gjer më sot në fshatin tonë. Po ç't'i bëj kësaj unë, (*Tregon Merushen.*) pa ta kisha trenguar qejfin që atë natë...

MERUSHJA — Dhe ti, ç'na i hap ato avaze tani. Futtuni brenda se ju dëgjojnë botë. Fundja që e la atë, mirë bëri.

ZARIKA — Dhe ti, baba, e nxore inatin. The vetë që do të të çoj në kursin e rrobaqepësisë dhe kur erdhi puna s'më le.

MERUSHJA — E, se mos u bë kiameti, nuk vajte këtë vit, vete vitin tjetër...

AXHEMI — Moj, atë ta shohë me dylbi, po të mbledhë mendjen dhe të rrrijë urtë se... (*Dëgjohet Lavdoshi që e thërret: O kryetar!*)

MERUSHJA — Dil se të kërkojnë. (*Axhemini del jash-të portës.*)

ZARIKA — Ç'ka sonte babai, moj mama?

MERUSHJA — Shëët! Mos e zgjat! Se kush ka bërë një anonime dhe thotë ca llafe dhe për ty me Agimin.

ZARIKA — Për çfarë?

MERUSHJA — Ku di gjë unë. Pyet tët atë. Ose, më mirë mos e ngacmo fare se kushedi se ç'na pjell pastaj. Hiqu sikur s'di gjë se ç'të thashë unë. Eh! Flasin gojët e liga, moj bijë, flasin.

ZARIKA — Të na marrin të keqen! Kur jam në rregull vetë s'kanë ç'të thonë.

MERUSHJA — Mos u kacaros kështu po mblidh mendjen se je në moshë për t'u martuar.

ZARIKA — Mos u shqetso se s'të ngelem në derë, jo.

AXHEMI — (*Lavdoshit.*) Ç'kemi? Po hajde brenda...

LAVDOSHI — Jo, jo. Po u ktheva pak të të them që i zoti i letrës u gjet.

AXHEMI — Kush është?

LAVDOSHI — Beqiri. S'paskemi gabuar. E verifikuan shkrimin arsimtarët. Doli që e kishte shkruar djali i motrës së tij. Pastaj në drejtori ai kishte treguar duke qarë se ia kishte dhënë daja për ta hedhur në të pastër.

AXHEMI — Hë, edepsëzi. Po na prish dhe fëmijët. Nësër ta nxjerrim para brigadës dhe ta demaskojmë mirë.

LAVDOSHI — Të mos nxitohemi. Të shohim njëherë  
dhe atë punën e përmbytjes së dy parcelave.  
Po të jetë dhe këtu dora e tij, atëherë kemi të  
bëjmë me punë sabotuese.

LAVDOSHI — Po e di përse kam ardhur tjetër?  
AXHEMI — Hë?

LAVDOSHI — Ka ardhur tek unë operativi i zonës.  
Kërkon të takohet me ne të byrosë.

AXHEMI — Kur?

LAVDOSHI — Sonte patjetër, tha. Pas një ore.

AXHEMI — I the për punën e letrës dhe misrit.

LAVDOSHI — I thashë. Po çështja është më e thellë.  
Më foli për një farë Spiro Thomai, që e kanë  
zënë. Ka pasur lidhje me dikë këtu në fshat.

AXHEMI — Tekniku i bletëve?

LAVDOSHI — Po po, atë teknikun e bletëve, e kanë  
arrestuar.

AXHEMI — (*I menduar.*) Ashtu, ë...

MERUSHJA — (*Del në derë.*) Ti Lavdo je? Po ejani  
brenda.

LAVDOSHI — Ika, ika. Natën e mirë! (*Axhemit.*) Unë  
po shkoj te zyrat e kryesisë. Mos u vono!

MERUSHJA — Natën e mirë!

AXHEMI — Erdha!

MERUSHJA — Ç'të donte?

AXHEMI — Për një punë. (*Zarikës.*) Po atë letrën ano-  
nime e more vesh?...

ZARIKA — Punë e madhe fort se ç'thonë bota. Lla-  
fazanët atë punë kanë. Ne kemi thjesht shoqëri,  
baba. Në organizatë na ka lidhur puna. Ai është  
djalë shumë i mirë. Ti e njeh vetë më mirë se  
unë. Unë çuditem pse ma thua këtë.

AXHEMI — Po njerëzit, poshtë e përpjetë, flasin.

MERUSHJA — E, le tē flasin. Kur e kemi nē rregull vajzën ne, le tē thonë c'të duan. Gojën s'ua mbyllim dot dhe tē duam.

ZARIKA — Do tē jetë ndonjë Veli me siguri. E di unë pérse e bën ai këtë. Se i mban akoma mëri Agimit që prej asaj ditës nē mal. Ai eshtë njeri me sedër tē sémurë. Këtë e bën pér Agimin.

AXHEMI — Nuk eshtë Veliu jo, janë tē tjerë që flasin.

ZARIKA — Kushdo që tē jetë, baba. Ju betohem që ne kemi vetëm shoqëri. A doni tē mos shoqërohem më me tē? Po po ta bëja këtë ai do tē ofendohej shumë. Ndaj unë këtë s'kam pse e bëj.

MERUSHJA — Lereni tani këtë muhabet se vajti vonë. E nesër do tē niseni përsëri nē mal. (*Shiu vazhdon tē bjerë. Agimi ka dalë nga porta e tij dhe troket te porta e Axhemit. Merushja del nē verandë.*) Kush eshtë?

AGIMI — Jam unë, nënë Merushe, Agimi.

MERUSHJA — (*Shkon i hap portën.*) Ç'ka ndodhur? Mos eshtë sémurë xha Agoja?

AGIMI — Sémurë, nënë Merushe.

MERUSHJA — Korba unë, do tē ketë marrë ndonjë tē ftohur mbrëmë. Mos u shqetëso, do t'i kalojë. Po urdhëro brenda.

AGIMI — Desha tē bisedoj pak me xha Axhemin.

AXHEMI — (*Del te veranda.*) Kush eshtë?

MERUSHJA — Agimi, Agimi eshtë. Agoja eshtë sémurë.

AXHEMI — Po eja brenda ...

ZARIKA — (*Del dhe ajo nē verandë.*) Do tē jetë ftohur. Dhe mbrëmë m'u duk si pa qejf.

AXHEMI — S'kemi as mjekun këtu. Ka shkuar nē fshatin e tij.

ZARIKA — Ta lajmërojmë nga posta, baba.

AXHEMI — Œshtë vonë. Kam frikë se s'na përgjigjet njeri nga posta e tyre.

AGIMI — Ç't'i bëjmë këtij shiu, xha Axhem? Do na i rrëzojë gjithë grurin përtokë.

AXHEMI — (*I nervozuar.*) E hëngri dreqi këtë punë, s'morëm masa. Na vajti dëm puna e bërë. Kam frikë sidomos për arat tek Shkëmbi i Kuq, ato janë të pjerrta dhe do e gërryejnë rrëketë tokën bashkë me grurë. Ta marrë djalli, ta marrë dhe këtë punë! Thashë unë, moti ka të papritura. Hé, ec e bëj prokopi tani . . .

AGIMI — Të shkojmë t'i lidhim duaj-duaj që tani, që të mos rrëzohen.

AXHEMI — S'është mëndim i keq. Po është dhe natë, kush i lajmëron njerëzit?

AGIMI — I biem çangës për alarm të mblidhen te zyrat e kooperativës.

AXHEMI — Po vallë, na mblidhen në gjithë këtë shi? Se kjo punë s'pret. Po u bë do bërë shpejt, pa humbur kohë.

ZARIKA — Shkoj unë bashkë me Agimin që tani e i lajmërojmë shtëpi më shtëpi . . .

MERUSHJA — Mirë thotë vajza. Le të shkojnë të dy të lajmërojnë ata të lagjes së Gjikbitajve.

ZARIKA — (*Axhemit.*) Ti si thua? Të shkojmë baba?

AXHEMI — (*Pasi mendohet pak.*) Shkoni!  
(*Agimi bashkë me Zarikën dalin me nxitim.  
Merushja i shoqëron me sy.*)

MERUSHJA — Djalë xhevahir! Sikur të na e kërkonte Zarikën unë për vete do t'ia jepja me të dy duart.

AXHEMI — (*Vesh xhaketën për të dalë.*) Ashtu thua ti? Që të thonë pastaj ja, fjalët që pëshpëriten poshtë e lart janë të vërteta.

MERUSHJA — Mor, thuaj që duket pak si derdimen në  
këto punë e s'na e kérkon, pa kush pyet pér fja-  
lët e botës. Ashtu si vijnë shkojnë. Dhe ti kot  
i bërtite vajzës.

AXHEMI — Kot, pse?

MERUSHJA — Se dhe ty të pëlqen ai djale. Paçka  
se s'të pëlqen ta thuash hapur...

AXHEMI — Psikologe e madhe zotrote!

MERUSHJA — Psikologe, posi. Sa i bërtite që të mos  
shoqërohej më me të e tani e lë ta shoqërojë.

AXHEMI — S'më ha meraku i Zarikës mua! E njoh se  
ç'vajzë kam!

MERUSHJA — Thuaj që e njeh dhe Agimin se ç'djalë  
është, pa e di unë sa e lëshon vajzën ti të shko-  
jë me një djale nëpër fshat natën.

AXHEMI — Ç'është e vërteta në fillim e pata një çi-  
kë me frikë punën e tij, po ke parë ti që pak  
nga pak na i hëngri të gjithëve zemrën ky dja-  
lë. Po me se thua ti!

MERUSHJA — Me punë. Punëtor i madh... S'ke ç'i  
thua. Nga mëngjesi gjer vonë në darkë në punë  
e ke.

AXHEMI — (*I vetkënaqur.*) Hë qerratai... Lajmëro  
këto dy familjet sipër dhe shko një çikë rri nga  
Agoja sa të kthehet Zarika, se unë po shkoj t'i  
bie çangës dhe pastaj kam një mbledhje në  
kryesi. (*Dalin të dy. Pas pak dëgjohet çanga.  
Në skenë, në gjysmë errësirë, nën shi vrapojnë  
njerëz dikush duke veshur xhaketën, ndonjë  
tjetër duke ndalur një moment sa të lidhë  
këpucën. Boshatiset skena. Dëgjohet vetëm  
çanga që vazhdon të bjerë.*)

## Tabloja e VI-të

(Në zyrën e kryesisë janë Lavdoshi, Axhem i dhe operativi i zonës.)

LAVDOSHI — (*Metes që sa hyn.*) Hë?

METIA — E lajmërova dhe Azbiun. Do të vijë.

LAVDOSHI — I the që kemi një mbledhje me rëndësi duhet të vijë patjetër?

METIA — Po, i thashë.

AXHEMI — (*Sheh orën, Lavdoshit.*) Duhet t'i mendojmë mirë të gjitha. Gabimi më i vogël na çon në dështimin e planit tonë.

OPERATIVI — Mos u shqetësoni. Janë marrë masat. Sonte patjetër diçka duhet të zbulojmë nga ky ballafaqim. Mjafton të kapet filli, pastaj lëmshi shqepet vet. Për ne ka rëndësi të vërtetojmë vetëm fajësinë. Kemi informata që tekniku i bletëve ka pasur lidhje në këtë fshat me Azbiun.

LAVDOSHI — Atëherë çështjet janë të qarta. Beqon do s'do, do ta detyrojmë ne të tregojë.

AXHEMI — Po vjen. (*Operativi dhe Metja dalin.*)

BEQIRI — (*Hyn me drojtje.*) Mirëmbërëma! (*Heq kaper-  
len.*) Më thanë se më kishit kërkuar, shoku Axhem.

AXHEMI — Pa ulu, ulu një çikë, çlodhu. (*Nxjerr pa-  
getën, i zgjat një cigare.*)

BEQIRI — Faleminderit, s'e pi!

AXHEMI — More, si është puna e asaj letrës anonyme? ...

BEQIRI — Pse pyet si është puna? Mos ju ka thënë njeri që e kam shkruar unë.

AXHEMI — Jo, ti nuk e ke shkuar, se je aq marifet-xhi sa tē hedhësh gurin e tē fshehësh dorën.

BEQIRI — (*Në dukje i ofenduar.*) Ju lutem shumë mos më fyeni, shoku Lavdosh. E kush e thotë këtë?

LAVDOSHI — S'të tha gjë nipçja...

BEQIRI — (*Si i çuditur.*) Jo! Pse? Ç'të më thoshte nipçja? S'po ju kuptoj fare, ku doni tē dilni me këtë?

LAVDOSHI — Hajde, hajde, mos na u hiq si budalla, se s'kemi dhe kohë tē merremi me ty, kemi punë tē tjera. Kujtuam se mos tregoheshe i zgjuar dhe na e hapje barkun vetë pér tē gjitha, por po s'deshe ti kemi dhe rrugë tē tjera.

BEQIRI — Ore, shoku Axhem, pér nder s'po kuptoj gjë.

AXHEMI — (*I rrëmbyer.*) Dëgjo këtu ti, larua i drexit! (*E mbërthen pér jake.*) E di ç'të bëj... Të marr shpirtin me duart e mia, kështu! Ti tē marrësh nëpër gojë vajzën time e tē shqetësosh partinë me shpifje tē tilla!...

LAVDOSHI — (*Ndërhyn dhe i heq' duart.*) Jo, jo kështu, shoku Axhem.

AXHEMI — Hajde, fol tani, ç'ke pér tē thënë pér tē tjerat. Lere punën e letrës, se ajo mori fund. Kush e lëshoi ujin në dy parcelat pranë lumit natën e 11 qershorit dhe e përmbyti misrin? Kush është ky?

BEQIRI — Ju betohem s'di gjë. Mos më ngatërroni mua me këto punë.

AXHEMI — Kush është Spiro Thomai dhe ç'të lidh ty me tē?

BEQIRI — Spiro Thomai?... Ju betohem, këtë emër ja këtu po e dëgjoj pér tē parën herë.

LAVDOSHI — (*Me ton tē butë.*) Dëgjo këtu ti: je zbuluar. Pra, s'ke nga ia mban. E mira ta do t'i tregosh tē gjitha, ashtu siç kanë ndodhur. Kjo ka rëndësi tani pér ty. Ta ul apo ta ngre fajin. Ti budalla s'je, e kuption vetë. Dikush tē ka zbuluar. Dëshmitarin e kemi këtu.

BEQIRI — Kush éshtë ai, nxirreni, ta besoj.

LAVDOSHI — Dakord, por po ta nxorëm s'do tē kemi më nevojën e pohimeve tē tua.

BEQIRI — Më vjen shumë keq, o sekretar. Çuditem. Kush éshtë ai që ju ka folur kështu pér mua?...

LAVDOSHI — Mos tē tē vijë hiç keq por eja, tundu... se s'kemi kohë. Mund tē tē hedhim dhe hekurat në vend. A e kuption që po e zgjasim shumë me ty.

BEQIRI — Ju lutem shumë, dua tē di kush éshtë ai njeri që më akuzon mua?

LAVDOSHI — T'ia themi?

OPERATIVI — Thuaja.

LAVDOSHI — Azbiu.

BEQIRI — (*I çuditur.*) Azbiu! (*Ngrihet instiktivisht në këmbë.*) E ç'ju ka thënë Azbiu pér mua?

LAVDOSHI — Që ti ke lëshuar vijën e ujit në datën 11 qershor dhe ke përblytur parcelat. Duhet ta dish, këto janë akte sabotimi që përfshihen në nenet ligjore. Përgjigju, kush tē udhëzoi ta bësh këtë?

BEQIRI — Asnjeri.

LAVDOSHI — Asnjeri? Aq më keq pér ty, atëherë ke vendosur me kokën tënde. Hë, fol?

BEQIRI — Ç'kërkoni tē flas, kur ju thoni që i dini tē gjitha. Pyesni Azbiun, ai do t'jua tregojë tē gjitha.

LAVDOSHI — Domethënë ti s'do tē flasësh.

**BEQIRI** — S'kam ç'të flas.

**OPERATIVI** — Mirë atëherë, ta lidhim. (*Bëhet gati t'i verë prangat.*)

**BEQIRI** — (Tmerrohet.) Jo, jo! Prisni.

**OPERATIVI** — Mjaft pritëm. Megjithatë, hajde fol!

**BEQIRI** — Do të më lini të kthehem sonte në shtëpi?

**OPERATIVI** — Po t'i tregosh të gjitha me sinqueritet fill e për pe dhe mund të na mbushet mendja të të lëmë.

**AXHEMI** — Përndryshe dije mirë, unë do të jem i pari që do kërkoj për ty dënimin më të madh.

**BEQIRI** — Ja, ja një minutë sa të më kujtohen të gjitha.

**OPERATIVI** — Ke përbënbytur misrin me kokën tënde apo ke qenë i udhëzuar nga të tjerë? Të kanë përdorur të tjerët si mashë pér të realizuar qëllimet e tyre?

**BEQIRI** — Po, po! Ashtu është!

**LAVDOSHI** — Si ashtu?

**BEQIRI** — Ja, ashtu si thatë ju. Më kanë përdorur të tjerët si mashë pér të realizuar qëllimet e tyre. Jam viktimi e një njeriu të poshtër.

**OPERATIVI** — Mashë e Azbiut?

**BEQIRI** — Si urdhëron! E Azbiut! Unë kam bërë q'më ka thënë ai. Ai më tha të lëshoja ujet dhe të përbënbytej misri, ju betohem pér këtë. C'ne unë ta bëja këtë. Unë jam frikacak prej natyre. Unë s'vras dot një pulë e jo të bëja një veprim të tillë.

**LAVDOSHI** — Po ja që e bëre.

**BEQIRI** — (Shpërthen.) Pér ndër, s'desha ta bëja unë por ai më kërcënoi se më kishte në dorë pér një dash të kooperativës që kisha marrë unë dhe që mund dhe të më vriste, po t'i dilte tymi kë-

saj pune. Ai éshtë njeri i poshtër. Ai jua ka më tē pabesë, ju betohem. Ai ka dhe armë...  
OPERATIVI — Armë? Nga e di ti?

BEQIRI — (Gëlltitet.) Hëm! Ja kam parë vetë. Ai më ka kërcënuar me revolver në dorë se plumbin e parë do ta harxhonte për mua po t'i zbulohen planet e veta. E shihni vetë! Ç'mund të bëja unë? Përndryshe më fluturonte koka dhe për vrasjen time kishte menduar mirë. Më mirë që u bë kështu. Shumë më mirë. Të paktën ju s'do të më vrisni.

LAVDOSHI — Qetësahu! Mblidhe veten! (Hyn Metia.)  
METIA — Ja tani po vjen Azbiu.

OPERATIVI — (I hedh prangat Beqirit e vë përpara dhe e çon në dhomën tjetër.) Ec përpara!

BEQIRI — Si urdhëron! (Del.)

LAVDOSHI — Çdo gjë e qartë. S'paskemi gabuar kur e vumë gishtin mbi të.

AXHEMI — Hë qeni i qenit. Na hiqej dhe si shok e si njeriu tonë më i besuar!... Për ideal, dhe vdekjen do ta kisha besuar po të na dilte Azbiu i tillë, jo! Paskemi mbajtur kaq kohë gjarpërin në gji, o Lavdosh vëllai.

LAVDOSHI — C'pyet. Pa le, po për pak na u fut dhe në gjak. Desh dhe na përzjeu fëmijët me njërit-tjetrin. Të na bëhej dhe krushk, pa le.

AXHEMI — (I indinjuar.) More, për krushk na e mori të keqen se kam vajzë kapedane unë. Pa, për mua qorrin për pak bitisi ajo punë. Ç'u bë qeni se s'po më durohet sa ta shoh.

OPERATIVI — (Hyn në skenë.) Asnjë fjalë! Kini kujdes mos u shpëtojë. Ai duhet t'i dorëzohet organeve të hetusisë.

AZBIU — (*Hyn. Sheh Axhemin.*) Mirëmbrëma! U vnova pak se më doli një punë. (*Vëren që në dhomë është Lavdoshi, Axhemini, Metia dhe operativi. Dyshon.*) Po gjene paskam ardhur në kohë, më duket.

LAVDOSHI — Tamam në kohë ke ardhur. Një çikë më shumë të vonoje do vinim ne të të mirrnim atje.

AZBIU — Ç'është kjo gjuhë, o Lavdosh?

LAVDOSHI — Kjo është gjuha jonë, o gjarpër i zi.

AZBIU — (*Ngrihet në këmbë.*) Ou!

OPERATIVI — Mos lëvizni! Jeni i arrestuar! (*I bën me shenjë Metes që ta lidhi.*)

AZBIU — S'po ju kuptoj. Ç'është kjo lojë, o Axhem Xafa? A më kini thirrur për mbledhje?

AXHEMI — Mjaft ke lojtur me ne, zoti Azbi. Tani do të luajmë pak ne me ty. Mbledhjen posa e mbaruam.

AZBIU — Epo, ç'tju them tjetër. Më paçi në qafë!

LAVDOSHI — Në qafë të paçin planet e tua armiqësore! Për të gjitha këto do të japësh llogari në tjetër vend.

OPERATIVI — (*Dy policëve.*) Merreni dhe këtë para!

### Tabloja e VII-të

(*Në shtëpinë e Agos*)

*Agoja dergjet në minderin pranë oxhakut.  
Është natë. Jashtë bie shi, vetëtin, bubullin.*

AGOJA — Zarikë! Zarikë, moj bijë! Po ku shkoi Agimi?

ZARIKA — Ta thashë, gjysh, kanë shkuar të gjithë të lidhin grurin te tarracat që hapëm matanë Shkëmbit të Kuq se ka rrezik të na e rrëzojë shiu pér tokë.

AGOJA — A, po po. Më the njëherë. Ç'nuk bëka njëriu po qe i bashkuar. Dhe shiun e bën zap. Po ti, moj bijë, pse s'shkove me ta?

ZARIKA — Po ty me kë të të lija?

AGOJA — Gabim. Të kishe shkuar. Ç'kam unë? Asgjë s'kam unë. Ndonjë të ftohur do kem marrë. (*Flet me vështirësi. Merr frymë thellë se s'e lë astma.*)

ZARIKA — Të ftohur ke marrë gjysh, kështu tha dhe mjeku. (*I jep një kokërr me një gotë ujë pas.*) Na pije. Do të të bëjë mirë.

AGOJA — E ç'do më bëjnë ilaçet!

ZARIKA — Pije, pije tani, gjysh. Të detyroj ta pish. (*E pi me zor.*) Kam porosi nga mjeku.

AGOJA — Më paç uratën, moj bijë! Pa ndihmomë të ngrihem pak se po më zihet firoma. (*Zarika i vë dy jastëkë nën vete.*) Hape pak dritaren.

ZARIKA — Jo, gjysh! Fryn erë. Nuk i dëgjon bubullimat?

AGOJA — Kur bie shi ngrihet vлага e tokës dhe lëshon një aromë që të kënaq shpirtin. Hape pak, moj bijë. Pleqtë kanë teka dhe mua më është tekur të ndiej aromën e plisave.

ZARIKA — Nuk bën, gjysh, se ftohesh më keq.

AGOJA — Ehë! Më duket se kësaj radhe ju lashë shëndenë. Po bixe shi jashtë, sikur the.

ZARIKA — Bie, gjysh, bie shi qershori që s'është parë kurrë.

AGOJA — Medet! Do të na e rrëzojë grurin fare përtokë. Pa le do ta ketë mbushur dhe atë gropën

time. (Zarikës.) Po të iki sonte nesër taksirat  
ju do të keni për ta zbrazur ujin...

ZARIKA — Dhe ty, gjysh, ku të shkon mendja.

AGOJA — Një sebep i duhet njeriut po u bë për udhë.

Po si the ti? Gruri eshtë në të bërë për drapër?

ZARIKA — Po gjysh. Në të bërë eshtë.

AGOJA — Epo, dhe do të korret atëherë. Do të kemi festë. Më lanë sytë fare, bija ime. Dje që dola s'e shquajta dot ishte i verdhur ndonjë çikë apo jo. (Blegërin dashi i tij.) Blegëriu i ziu... Blegërin... (Buzëqesh nën buzë.) Kërkon heje. I hodhe hejë dashit?

ZARIKA — I hodha gjysh, i hodha.

AGOJA — Ashtu më paç uratën! Ashtu. Pa afrohu një çikë këtu pranë të të shquaj. (Zarika i ulet pranë. Ai i përkëdhel flokët.)

Paç uratën, moj bijë, për të gjitha sa ke bërë për mua, se unë vajza paç e ti m'u bëre vajzë e shkuar vajzës. Edhe Agimi që u kthyte këtu e s'e harroi vatanin e tij, mal ma bëri zemrën. E unë një visijet kam për të dy ju. Ia kam thënë dhe atij, po ai s'iа prish qejfin gjyshit, po ta them dhe ty.

ZARIKA — Ç'farë gjysh?

AGOJA — Mos m'i lini këto bina të shkreta. Këto bina janë të lashta, të tjerë m'i kanë lënë mua e unë po jua lë juve. Mbahen mend që në kohë të Ali Pashës, dhe më parë. Iku Beluli la Shefqetin, iku Shefqeti la tim atë, Dalanin, iku Dallani më la mua, Agon. Agoja mirë që dhe atje ku ishte po s'donte që të këndonte bufi në shtëpi të tij dhe të rritej bari gurëve të obo-rrit. Iki tanë unë, po e di që lë Agimin pas. Sejeta kërkon të përtërihet, bija ime, më paç

uratën. Kjo është dhe bukuria e saj. Shkon gjaku te gjaku nga një brez në tjetrin. E njeriu ikën një ditë po e di që ai dhe vasijetet e tij jetojnë në nipë stërnipërit e tij. Kuptove, më paç uratën? (Zarika ul kokën.)

(Dëgjohet një këngë së largu, Agoja mban vesh dhe dëgjon):

Kutasi flak e flamur,  
bukën vet do ta prodhojmë,  
në tarracat shkëmb e gur,  
atdheun kështu forcojmë . . .

ZARIKA — Janë të rintjtë e fshatit, gjysh. Siç duket kanë dalë me sukses se po këndojnë. Po do jenë lagur e do jenë bërë ujë nga shiu.

AGOJA — Sa bukur këndojnë! Këngë më të bukur nuk kam dëgjuar në jetën time.

ZARIKA — E kemi krijuar vetë gjysh; për festivalin midis fshatrave që do të bëhet këtë muaj në Vlorë.

AGOJA — Hë, m'ju lumtë goja, bijtë e xha Agos. Ashtu është vërtet, siç thotë kënga. E dhatë fjalën po e mbajtët me nder. (Dëgjohet zhurmë. Në skenë hyjnë Axhemini me Lavdoshin, pas tyre vijnë Agimi dhe të rinj të tjerë të fshatit.)

LAVDOSHI — (I shkon pranë dhe e takon.) Si je, xha Ago? Më mirë më dukesh.

AGOJA — (Mezi e shquan.) Ti Lavdosh je?

LAVDOSHI — Po, unë, Axhemini, Agimi, e plot të tjerë. Sa u kthyem nga aksioni, donim të të shihnim.

AGOJA — Më paçit uratën, bijtë e mi, që erdhët të pigeni me xha Agon. Dikur, kur niseshim në kurbet, na përcillnin vetëm të afërmit se fshati

ishte i pérçarë nga hasmëritë e i katandisur pér ibret nga varfëria. E tani në shtëpinë time ka ardhur Partia dhe pushteti, rinia dhe farefisi im. E, ç'nder më i madh do t'i bëhej Agos se ky që po më bëni ju?

**LAVDOSHI** — Përmende kurbetin, ti xha Ago, po ne s'kemi ardhur pér të përcjellë njeri në kurbet. Na tha Agimi që ishe pak pa qejf dhe erdhëm të të shihnim.

**AGOJA** — Më paçi uratën. Dhe unë kot e thashë s'e s'ikën kollaj Agoja nga kjo botë. Po një qejf do të kisha të ma plotësonte kjo rinia, meqë u merakos pér mua e ma mbushi shtëpinë.

**AGIMI** — Fol, gjysh!

**AGOJA** — Do desha të këndonit një këngë pér të kluarën e fshatit tonë. Pér vuajtjet që ka hequr ky fshat nga luftërat e nga bejlerët e agallarët. Hë, a gjeni dot një këngë të tillë ta këndoni? (Të gjithë shohin njëri-tjetrin në sy.)

**AGIMI** — Të themi të drejtën s'na kujtohet ndonjë tani.

**AGOJA** — Ashtu? Ja, po jua kujtoj unë:  
Jemi rriturë në brinjë — thoni  
me lak të shkretat opinga  
bëjmë qull e pjekëm kila,  
po tashti që na erth e mira... hë ju kujtohet tani?

**AXHEMI** — S'këndohet në shtëpinë e të sëmurit, xha Ago.

**AGOJA** — Kush është sëmurë? Ju thatë vetë që jam më mirë. Apo s'është kështu, o Lavdosh!

LAVDOSHI — Ashtu është. Por ti i di më mirë zakonet se ne, xha Ago, mos na kërko të bëjmë një gjë që s'e bëjmë dot.

AGOJA — Epo, mos i thoni xha Agos je më mirë. Se xha Agoja e kupton që i thoni për t'i bërë qejfin.

LAVDOSHI — E mirë atëherë, bëjani qejfin xha Agos. Këndoni:

(*Të rinjtë nisin dhe këndojnë labçë.*)

Jemi rriturë në brinjë  
me lak të shkretat opinga,

AGOJA — (*Ndërpresin këngën se shohin që xha Agoja fillon të përlotet.*) Është buka, bijtë e mi, ështëjeta, S'janë gjëra të shpikura nga mendja. E kam gjetur këtë fshat sterrë e mavri, e u bëtani me njerëz të bashkuar që jetojnë e punojnë të gëzuar, me bukë e me gjithë të mirat. Nashti, më paçi uratën, kullon mjaltë, mjaltë dynjaja . . . (*Agimi, që ka sjellë kallinjtë e grurit nga toka malore, ia çon Agos.*)

AGIMI — Merri. (*Agoja i prek me dorë, buzëqesh.*) Është gruri i tokës malore. Bëhet gruri dhe në gur me këtë Parti, the ti, dhe ja, u bë.

AGOJA — Hë, më ju lumtë, bijtë e mi. Agoja tha vërtetë bëhet, por ju e bëtë ama. Kështu të bashkuar ia nisët punës dhe ia dolët mbanë, fajqebardhë. E bëtë dhe gurin të jeshilojë. E kujt ia priste mendja që këta shkëmbinjtë tanë do nxirrnin bukë e do ngopej fshati me bukë mali? Po ja, tha Partia që bëhet dhe ju po e bëni. Hë, më ju lumshin krahët! E mua m'u sos fitili dhe po nuk qeshë në atë dasmë, po u le të gjithë të

bashkuar, lë pas gjithë një popull të bashkuar, lë shqipërinë si nuse me Enver Hoxhën në krye e me Partinë si zonjë. Ndaj le të buçasë shtëpia ime nga kënga si në një festë të madhe. (*Agoja ia merr këngës vet. Të gjithë i mbajnë iso duke qëndruar së bashku rrëth e rrrotull. Agoja qëndron në një pozicion epik midis tyre.*)

Kutasi flak e flamur  
bukën vet do ta prodhojmë,  
fjalën ia mbajtëm Partisë  
atdheun kështu forcojmë.

— Fund —